



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

//

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Master Profesional në
“Infermieri Kirurgjikale”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë
“Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


1. Dr. Etleva Rustami

2. Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli

Prill 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë Univeriteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekesore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 744, date 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Nr. 1118 Prot. Datë 10.10.2016
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 i Komizës Shqiptare të Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/4
18	Numri i studentëve:	0
19	Komente / të tjera:	-





PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (UNIEL) është një Institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me Nr. 4964/3 Prot. datë 03.12.1991. Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore është hapur me urdhërin Nr. 187, datë 07.05.2012 të Ministrit të Arsimit. Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është hapur me vendimin VKM Nr. 744, date 05.09.2013. Ky program studimi është riorganizuar dhe Ministria e Arsimit është informuar mbi ndryshimin nga 90 kredite në 60 kredite me shkresën Nr. 1118 Prot. Datë 10.10.2016. Institucioni është i akredituar nga ASCAL për një periudhë gjashtë vjeçare deri më 26/11/2026. FSHTM ka në përbërje të vet katër departamente:

- Departamenti i Infermieristikës
- Departamenti i Lëndëve Klinike
- Departamenti i Lëndëve Para Klinike
- Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore

Departamenti i Specialiteteve Tekniko Mjekësore (DSTM) i cili ofron programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" ka në përbërjen e vet 8 pedagogë me kohë të pa caktuar (3 Prof. Asoc, 2 Doktor Shkencash, 1 PhD candidate dhe 1 me Master Shkencor) ndërsa numëri i personelit me kontratë me kohë të caktuar është 25 në total (3 Doktor Shkencash dhe 22 me Master Shkencor). Programi i studimit ofrohet sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe për të fituar këtë diplomë duhen 60 kredite (ECTS). Kohëzgjatja e studimeve është 1 vit akademik dhe forma e studimit është me kohë të plotë. Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe aktet nënligjore.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” që ofrohet nga Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekësore (DSTM), Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga intitucioni, si dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti i Elbasanit, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Në kuadër të procesit të jashtëm të vlerësimit është përgatitur agjenda nga ASCAL dhe është kryer vizita në data 18-19 Janar 2023.

GVJ përbëhet nga Dr. Etleva Rustami, Prof. Asoc. Enkelejd Mëhilli dhe përfaqësuesja e ASCAL, Znj. Rajna Lila.

Bazuar në agjendën e përgatitur nga ASCAL, ditën e parë u zhvilluan takimet me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe të Njësisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u zhvillua vizita në sekretarinë mësimore si dhe në ambientet e Fakultetit. Gjatë vizitës në Fakultet u panë klasa, laboratorë të ndryshëm si dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte ajo e parashikuara në agjendë dhe nuk kishte ndryshime.

Ditën e dytë, GVJ zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore ku diskutoi mbi çështje të ndryshme ndërsa më pas zhvilloi një takim ku merrnin pjesë përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni, përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrdhënieve me Jashtë si dhe të NJSBC. Në fund të takimeve, GVJ vizitoi dhe bibliotekën qendrore të UNIEL. Me përfundimin e takimeve, GVJ takoi Drejtuesin e Departamentit ndërsa eksperti i ASCAL do të informonte koordinatoren Institucional mbi disa dokumenta shtesë. Në përfundim të vizitave, ekspertët në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, takimeve të zhvilluara si dhe vizitës në ambientet e Institucionit hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Me datë 06/03/2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 2/34 Prot, Datë 06/03/2023, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 642/7 Prot, Datë 09/03/2023.

GVJ pasi u njoh me komentet e bëra nga Universiteti i Elbasanit lidhur me DRVJ, sqaron si më poshtë:

Mbi komentet e Universitetit të Elbasanit lidhur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” të këtij Institucioni.

Komentet lidhur me plotësimin e sugjerimeve të Intitucionit:

GVB: Standardi II.3/kriteri 4: Në lidhje me silabusin e temave të praktikës Jua kemi nisur pas kërkesës tuaj (**për plotësim dokumentacioni**) të skanuara dhe të ngarkuara përmes platformës së ASCAL.

1. GVJ: Faleminderit për përgjigjen tuaj. Temat e praktikës janë ngarkuar në sistem pas kërkesës sonë, por ajo që ne theksojm është një ndryshim në formën e syllabuseve midis pedagogëve si dhe një mungesë në disa prej syllabuseve të objektivave të mësimnxënies si dhe rezultatet që priten nga studentët. Për këtë arsye GVJ konsideron të rëndësishme që të ndiqet formati standard nga të gjithë pedagogët që zhvillojnë leksione në këtë program studimi.

GVB: Standardi III.3/kriteri 4: Është e bazuar në nenin 37 të rregullores së DSTM, pika 1 dhe 2 (rregullorja e DSTM e ngarkuar në sistem së bashku me RVB, respektivisht evidenca 1.7.1 rregullore e DSTM dhe evidenca 1.7 Regullore e FSHMT)

2. GVJ: Në raportin e vlerësimit të brendshëm si dhe gjatë takimeve në IAL, u raportua se pedagogët zhvillojnë një procedurë ku pasi korrigjojnë provimet i mbledhin në klasë studentët (ose zhvillojnë seanca sqaruese) dhe u komunikojnë rezultatet. Kjo procedurë nuk parashikohet qartë tek neni 37 i Rregullores së DSTM. GVJ propozon plotësimin e kësaj procedure në rregulloren e DSTM.

GVB: Standardi III.3/kriteri 7: Bazuar dhe në rregulloret përkatëse të DSTM, FSHMT dhe EMS afati kohorë në dispozicion parashikon se ka hapsira kohore 3-4 ditë për korigjime dhe 2-3 ditë është koha në dispozicion për anikimim nga ana e studentëve.

3. GVJ konstatoi në Rregulloren e DSTM (Neni 38 pika 2) se *“Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve”*. Për këtë pikë GVJ propozon që afati kohor të jetë 2-3 ditë siç theksohet në përgjigjen tuaj.

GVB: Standardi IV.3 /kriteri 2: Literatura e huaj e cila përdoret si literatur mbështetëse është personale e siguruar nga vetë petagogu ose mund të aksesohet online nga platforma u-library dhe JSTORE, Për këtë arsye nuk mund të gjendet kopje fizike në bibliotek.

4. GVJ: Faleminderit për sqarimin e kësaj pike. Pavarësisht aksesit në platformat elektronike u-library dhe JSTORE, GVJ, konsideron si të rëndësishme prezencën e literaturës edhe në formën fizike në bibliotekë.

GVB: Standardi IV.3/kriteri 5&6: Ka mospërputhje në sygjerimin e GVJ në standartet 5&6. Sipas raportimit të studentëve (kriteri 6) ata përdorin kompjuterat në shkoll për të aksesuar u-library dhe JSTORE, ndërsa në kriterin 5 po të këtij standardi citohet se studentët nuk kanë njohuri për mënyrat e aksesimit të librarive online (probalisht duhet të jete një lapsus).

5. GVJ: Faleminderit për konstatimin tuaj. Ajo që është përmendur tek kriteret 5 dhe 6 është diçka ndryshe. Institucioni u jep mundësinë studentëve të kenë akses në biblioteka on-line dhe pa kosto ndërsa bibliotekat sipas vizitave të zhvilluara në terren ishin të pajisura me kompiutera në të cilat studentët kishin mundësi ti përdornin pa kufizim. Ajo që konstatoi GVJ në takimin me studentët dhe që përmendet tek Standardi IV.3, kriteri 5 është se studentët raportuan që nuk kishin njohuri për mundësinë e aksesimit të bibliotekave on-line. Për këtë arsye propozojm zhvillimin e takimeve informuese me studentët me qëllim njohjen e tyre me këtë mundësi.

GVB: Standardi IV.4/kriteri 4: Sistemi EMS është një sistem i cili implementohet për informacionin administrative-didaktikë ku studentët informohen në kohë reale me informacionin në lidhje me lëndët, kreditet, orarin, nr totalë të krediteve të grumbulluara gjatë simestrave, lëndët e zhvilluara dhe ato që kanë mbetur pa u zhvilluar. Në kete system student gjen dhe

pyetsor në lidhje me shërbimet, tarifat e studimit etj. Gjithashtu në kete system ka dhe një kontakt me administratorët e sistemit EMS. Ndërsa për komunikim me petagoget studentët po tek kjo platforme kan adresen elektronike personale apo zyrtare të petagogut të seciles lënde,për komunikim interaktive.

6. GVJ: Faleminderit për sqarimin. Është e qartë si nga raporti i vlerësimit të brendshëm ashtu dhe nga takimet me grupet në terren roli dhe funksioni i rëndësishëm i EMS-së. GVJ propozon që përmes EMS-së pedagogët dhe studentët të kenë mundësi për komunikim interaktiv.

GVB: Standardi IV.5/kriteri 3: Raport auditit UNIEL?

7. GVJ: Në dokumentacionin e përcjellë nga UNIEL, është dorëzuar raport auditimi i jashtëm (MAS) por jo një raport auditimi nga sektori i Auditimit të Brendshëm. Ky sektor është në organigramën e UNIEL (Evidenca 1.11).

GVB: Standardi V.5/kriteri 1&2: Dokumentacion mbi aktivitetet e këshillit studentor (UNIEL).

8. GVJ: Në dokumentacionin e dorëzuar, mungonte dokumentacion mbi aktivitetet e organizuara nga Këshilli studentor.

GVB: Standardi VI.1/kriteri 3: Raporti i pyetsorit përvec gjetjeve përmban dhe rekomandime për përmirsimin e punës dhe me pas këto rekomandime përkthehen në plane konkrete të përmirsimit të punës.

Përvec tyre; rekomandimet; sygjerimet; vërejtjet dhe vlersimet e tjera janë me vend.

9. GVJ: Faleminderit për sqarimin. Në raportin e hartuar në bazë të rezultateve të pyetësorit siç përmendet edhe në raportin e GVJ përfshihen rekomandime. Ajo që GVJ vëren është mungesa e një plani masash për implementimin e këtyre rekomandimeve duke përfshirë objektivat specifike, afatet kohore, strukturat që nevojiten të përfshihen si dhe rrisqet e mundshme.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>enaxhim Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Institucioni ofron programin “Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” me qëllim marrjen e njohurive të thelluara në këtë program studimi, kjo argumentohet në koherencë me kërkesat e tregut të punës, si dhe nevojën në thellimin e njohurive të studentëve që kanë mbaruar ciklin Bachelor. Njohuritë e përfituara në këtë fushë studimi i përgjigjen interesit kombëtar. Ky program studimi mbështetet në studimet në fushën e Infermierisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe ekzaktësisht të Departamentit të Specialiteteve Tekniko Mjekësore.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Institucionit</i> <i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e Zhvillimit të FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Ky program studimi mbështetet në strategjinë e Institucionit të Universitetit të Elbasanit si dhe në strategjinë e Njesisë Kryesore duke zbatuar konkretisht qëllimet në lidhje me fushën e studimit, në fushën e Infermierisë. Ky program studimi përmbush qartazi objektivat strategjike të institucionit, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike si dhe të Departamentit që ofron këtë program studimi Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Institucioni referon që rezultatet e studimit të tregut të punës, dëshmojnë për rëndësinë e programit.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.2 Rregullore e UNIEL</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL</i> <i>Evidenca 1.3.1 Startegjia e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Studimit të FSHMT</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Në strategjinë e UNIEL, përshkruhet se programet e studimeve janë të hartuara për të nxitur zhvillimin ekonomik. Në funksion të këtij vizioni si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi, Departamenti konsideron si prioritet progresiv evoluimin dhe forcimin e studentit, i cili pas përfundimit me sukses të ciklit të dytë të studimit pajiset me diplomë universitare Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe është i aftë të mbulojë një shërbim profesional të specializuar infermieror në kushte spitalore ose ambulatorie dhe mund të punësohet në sektorë publik e privat ku lind</p>

Medi

Rusti

	<p>nevoja e menaxhimit dhe përdorimit të sistemeve të ndryshme bashkëkohore duke u përshtatur më së miri edhe me teknologjitë inovative që i paraprijnë kohës.</p> <p><i>Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL</i> <i>Evidenca 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të UNIEL</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe e funksionimit të UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve të DSTM</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare. Programi është në përputhje me vizionin, si edhe në vijim të arritjes të objektivave strategjike të këtij programi studimi. Departamenti konsideron si prioritet progresiv evoluimin dhe forcimin e studentit, i cili pas përfundimit me sukses të ciklit të parë të studimit pajiset me diplomë universitare Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ky student është i aftë të mbulojë një shërbim profesional të specializuar infermior në kushte spitalore ose ambulatorë dhe mund të punësohet në sektorë publik e privat, ku lind nevoja e menaxhimit dhe përdorimit të sistemeve të ndryshme bashkëkohore duke u përshtatur më së miri edhe me teknologjitë inovative që i paraprijnë kohës.</p> <p>Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” dhe strategjia e zhvillimit të tij është hartuar në përputhje me programin e studimit dhe argumentohet që realizohet në përputhje me vizionin dhe strategjinë e interesat kombëtare si dhe mbi fokusin global të zhvillimit kombëtar përshkruar në ligjin Nr. 80/2015 Datë 22.07.2015 “për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit</i> <i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e Zhvillimit të FSHMT</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ky program studimi ofrohet në dakordësi të plotë me interesat kombëtare si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UNIEL. Programi ofrohet bazuar në aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet e hartuara dhe miratuara nga vet institucioni. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>



<p>Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Institucioni referon që UNIEL është një Institucion i Arsimit të Lartë i kategorisë së Universiteteve të themeluar në 1991. Ai referon që ka burimet e duhura në fushën akademike, si dhe për fushën specifike. Nga dokumentacioni i depozituar, duket që institucioni ka kapacitetet dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij program studimi. Referuar vizitës që</p>

	<p>GVJ, bëri në institucion dhe pasi mori informacion të hollësishëm mbi këtë program, mund të themi se ky institucion i ka kapacitetet dhe burimet e duhura në këtë fushë akademike.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL.</i> <i>Evidencë 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>Evidenca 2.15 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe nrastrukturën e Fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Për programin e studimit Institucioni referon se, Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në 5 kategori, nga A; B; C; D dhe E.</p> <p>Kategoria A: Lëndë bazë/përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese/përgatitje për disiplinën shkencore</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese/grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje.</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese/gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale</p> <p><i>Evidenca 1.3.1 Strategjia e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Studimit e FSHMT,</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” referohet që është një program i cili i përgjigjet fushës specifike të programit të Departamentit të Specialiteteve Teknike Mjeksore dhe fusha e studimit referohet që është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit të kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve Kombëtare e Evropiane.</p> <p><i>Evidenca 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit.</i> <i>Aneks Tabela 19</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Institucioni nuk ofron një rast të tillë.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të</p>	<p>Institucioni nuk ofron një rast të tillë.</p>

mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.									
Konkluzione	<i>Institucioni ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit janë në përputhje me fushën kërkimore të Njesisë Kryesore si dhe të Njesisë Bazë. GVJ vleron se ky standard përmbushet plotësisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet njësisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet njësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet njësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Institucioni referon se, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, UNIEL siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrative financiare e institucionit, pasqyrohet në analizën vjetore institucionale. Sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe asaj Bazë, bashkëpunimi dhe asistimi është një nga themelet kryesore të funksionimit të këtij Institucioni.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e studimeve të FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve të DSTM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i> <i>Evidencë 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021</i> <i>Takimi me Dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit</i></p>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve me Drejtuesit e Fakultetit, në lidhje me realizimin e procesit mësimor në kryerjen e praktikave dhe arritjen e objektivave, institucioni rezulton se ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet përkatëse. Mbi bazë të këtyre marrëveshjeve Institucioni bën të mundur zhvillimin e praktikave të studentëve. Institucioni realizon praktikat në marrëveshje me institucione homologe brenda vendit, në institucione publike dhe private.</p> <p><i>Evidencë 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020- 2021</i> <i>Evidencë 1.12.1 Analiza vjetore e DSTM 2020-2021</i> <i>Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>

<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e programit të studimit. Marrëveshje janë nënshkruar me Spitalin Rajonal si dhe Spitalin Psikiatrik të qytetit. Po ashtu marrëveshje bashkëpunimi janë nënshkruar edhe me Operatorin e Kujdesit Shëndetësor me qëllim zhvillimin e praktikave në qendrat shëndetësore. Studentët përmes programit Erasmus kanë mundësinë e mobilitetit dhe kryerjen e praktikës profesionale dhe në Institucione jashtë vendit.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkpunimit.</i> <i>Evidencë 1.14. Lista e marrëveshjes për programin e praktikës</i> <i>Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+ Takimi me Dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni referon në lidhje me Departamentin e Specialiteteve Teknike Mjeksore, i cili ofron një program, si dhe analizon përfitimet që sjellin marrëveshjet e bashkëpunimit, në funksion të programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” të cilat raportohen në raportin e analizës vjetore.</p> <p><i>Evidencë 1.12. 1 "Raporti i analizës vjetore te departamentit 2020-2021"</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Sipas dokumentacionit të depozituar si dhe vizitave në terren, GVJ konstaton se UNIEL siguron mardhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit. Paralelisht, Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tjera Brenda dhe jashtë vendit me qëllim zhvillimin e praktikave. Sipas GVJ ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			X	
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			X	

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Masterit Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara me kredite, sipas Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka 60 (ECTS), 1500 orë. Lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Plani mësimor përfshin leksione, seminare, praktikë profesionale, provim. Lëndët janë të ndara sipas kategorive.</p> <p>A –Lëndëbazë– përgatitjet metodologjike dhe kulturë përgjithshme. B –Lëndë karakterizuese– përgatitjet për disiplina shkencore. C –Lëndë ndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina, profiedhe grup-lëndë me zgjedhje. D –Lëndë plotësuese– gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale. E –Detyrime përmbyllëse.</p> <p>CVJ vlerëson që të rishikohet rritja e numrit të orëve të praktikës.</p> <p><i>Tabela 9 - Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit MPIK Evidencë 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Qëllimi kryesor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” formimin e shprehive të veçanta dhe të përgatisë specialist të nivelit të lartë dhe të qëndrueshëm në shkencat larmi të gjerë profesionale e infemierore. Të gjitha lëndët klinike në këtë program pasohen nga ato të specialiteteve, duke u dhënë studentëve njohuri infemieristike duke mundësuar vlerësimin kritik të patologjisë, diagnostikimit të përparuar në një fushë studimi ose trajtimit klinik dhe paralelisht implementimin efektiv të procesit infemieror, punësimin, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. Lëndë të ndryshme si Kirurgji e Avancuar, Infemieristikë Kirurgjikale, Lirurgjia Onkologjike, Farmakologji Klinike etj. përfshihen me qëllim përgatitjen më të mirë të mundshme të studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregulloret e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” njohuri, aftësi dhe kompetenca” Evidencë 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “MP në Infemieri Kirurgjikale” Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të</p>	<p>Është parashikuar një ngarkesë prej 5 ETCS për praktikën profesionale ndërsa studentët në fund të vitit akademik testohen me provim për</p>

<p>përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>praktikat profesionale përmbyllëse të realizuara gjatë vitit nëpër repartet spitalore. Plani mesimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p> <p><i>Evidencë 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p> <p><i>Evidencë 2.9 Plani mesimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Institucioni nuk ofron një rast të tillë</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Institucioni nuk ofron një rast të tillë</p>

<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar në përputhje me Ligjin "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor. Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nr. 80/2015, date 22.07.2015. Aktet rregullatore të hartuara nga Institucioni janë në përputhje me kuadrin ligjor egzistues si dhe të gjitha procedurat në lidhje me format e organizimit të studimeve, pranimin e studentëve dhe financimin e tyre në UNIEL realizohen në përputhje me këtë ligj dhe VKM-të përkatëse, si dhe në udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pranimi i studentëve zhvillohet duke ndjekur një procedurë standarte sipas kuadrit ligjor. Njësia Bazë harton kërkesat të cilat përmes Njesisë Kryesore i përcillen Senatit Akademik për miratim. Pas miratimit, ato i përcillen MAS si dhe QSHA.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e Institucionit</i> <i>Evidencë 1.14 Rregullore e departamentit të SMT,</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve të DSTM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 1.8.2 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 4.17 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” që ofrohet në ciklin e dytë Master, është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Elbasanit "A. Xhuvani, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit. Sipas diskutimeve të zhvilluara me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe asaj Bazë studentët të cilët vazhdojnë studimet jashtë apo/ose aplikojnë për punësim, programi i studimit u njihet pa probematika. Ky program studimi është i ngjashëm me programin që ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Tiranë, Universitetin e Mjekësisë Tiranë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Misioni dhe qëllimi i departamentit të STM, lidhet me fushën e Infermierisë.</p> <p><i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Ky program i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. (KSHK).</p> <p><i>Evidencë 1.17 Urdhëri për hapjen e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mesimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit</p>	<p>Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga</p>

mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".		
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" (i përket nivelit 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve) pëmban të gjithë elementet e strukturës së programit të studimit të përcaktuara në aktetet ligjore e nënligjore. Programi i studimit ka ngjashmëri me programe të njëjta të cilat ofrohen brenda dhe jashtë vendit ndërsa secila lëndë ka nr. kreditesh specifik. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i Specialitetete Teknike Mjekësore është pjesë e FSHMT i cili ka përgjegjësi për programet që ofrohen në 4 departamente. Departamenti i Specialiteteteve Teknike Mjekësore ka në përbërjen e vet 8 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë. Tre janë të kategorisë Prof. Assoc, 2 të kategorisë Doktor Shkencash, 2 janë në proces doktorature dhe një me Master Shkencor. Numëri i personelit ndihmës akademik është 2 ndërsa Departamenti ka dhe 25 anëtarë me kohë të pjesshme nga të cilët 3 janë Doktor Shkencash dhe të tjerët mbajnë gradën Master Shkencor.</p> <p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit në drejtim të mësimdhënies:</p> <p>a. Përgjigjet për formulimin e profileve, si dhe të përmbajtjeve lëndore, për diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit, si edhe programet me karakter profesional që ndodhen nën administrimin e tij;</p> <p>b. Administron dhe organizon profilet e kërkimit shkencor që orienton diplomat e ciklit të dytë të studimit, sidomos projektet kërkimore në bazë të studimeve;</p> <p>c. Bashkëpunon me departamentet e tjera të Universitetit për zbatimin e planeve mësimore</p> <p><i>Evidencë 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL</i> <i>Evidencë 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional</i> <i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHMT-së</i> <i>Evidencë 1.16 Urdhër "Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Teknike Mjekësore"</i> <i>Evidencë 1.17 Urdhri për hapjen e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional</i></p>

	<p>në "Infermieri Kirurgjikale"</p> <p>Tabela 1 - Numri i personelit akademik për gdo njësi bazë;</p> <p>Tabela 2 -Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Institucioni referon se praktikat profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", janë të organizuara konform Rregullores së Studimit të FSHMT. Institucioni referon se përmbush detyrimet ligjore dhe se praktikat janë të përcaktuara në secilin shërbim shëndetësor, përkatësisht kirurgji, maternitet, urgjencë, ambulancë qendrore. Institucioni referon se ka angazhuar personel ndihmës akademik/administrative për realizimin e praktikave. Përgjegjësi i njesisë bazë i cili është edhe koordinatori akademik, bën ndarjen e punës për koordinatorët e ndjekjes së praktikave profesionale përkatësisht në të gjithë institucionet ku Universiteti ka marrëveshje. Në përbërje Departamenti ka 2 personel ndihmës akademik si dhe 25 personel akademik të jashtëm të cilët asistojnë në zhvillimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>Evidencë 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i> <i>Evidencë: 1.14.1 Paketa e praktikës për programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2.9: Plani mësimor i programit të studimit "Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale"</i> Tabela 1 - Numri i personelit akademik për gdo njësi bazë; Tabela 2 -Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Institucioni ka emëruar një koordinator për këtë program studimi. Koordinatori është emëruar nga Drejtuesi i Departamentit ndërsa detyrat e tij janë përcaktuar qartë në një rregullore specifike të miratuar. Institucioni referon se orët e zhvilluara në praktikat profesionale (klinike) organizohen dhe ndiqen nga stafi akademik për këtë program studimi. Njësia bazë cakton një përgjegjës për programin dhe mbikqyrjen nga përgjegjësi gjithashtu i personit në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës infermieror i Departamentit të Specialiteteve Teknike Mjekesore. Koordinatori është përgjegjës për realizimin e programit të praktikave si dhe për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e Fakultetit.</p> <p><i>Evidencë: 1.14.1 Paketa e praktikës për programin e studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2. 10 Vendim për caktimin e koordinatorit të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2.11 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia Bazë e cila ofron këtë program studimi përmbush të gjitha kriteret ligjore e nënligjore. Ajo ka në përbërje të saj staf akademik,</i></p>



	<i>ndihëms akademik dhe administrative. Paralelisht, ky program studimi ka një coordinator të emëruar. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni referon se është në Kompetencat e Drejtuesit të Departamentit të disponojë informacionin e nevojshëm për organizimin e programit, si dhe përmbajtjen e tij.</p> <p>Njësia kryesore bazë është përgjegjëse në drejtim të mësimdhënies:</p> <p>a. Përgjigjet për formulimin e profileve, si dhe të përmbajtjeve lëndore, për diplomën e ciklit të dytë që ofron dhe ndodhet nën administrimin e tij;</p> <p>b. Administron dhe organizon profilet e kërkimit shkencor që orientojnë diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë të studimit, sidomos projektet kërkimore në bazë të studimeve të Doktoratës;</p> <p>c. Bashkëpunon me departamentet e tjera të Universitetit për zbatimin e planeve mësimore;</p> <p>c. Parapërgatit çdo vit planin e integruar të kërkimit shkencor dhe kërkesat për financimin e nevojshëm për realizimin e një programi të zhvillimit dhe të fuqizimit të kërkimit shkencor, si dhe për kryerjen e aktiviteteve në mbështetje të aktivitetit akademik, i cili i parashtrohet për miratim Dekanit të Fakultetit në afatet e përcaktuara.</p> <p>d. Përgatit raportin vjetor për veprimtarinë kërkimore shkencore të kryer nga personeli akademik i departamentit.</p> <p>Organizimi dhe struktura e njësisë është në përputhje me planin strategjik të UNIEL si dhe të Fakultetit. Pjesë e informacionit gjendet edhe në faqen zyrtare të Institucionit dhe është e disponueshme për studentët dhe publikun. Paralelisht, në systemin EMS gjendet informacion mbi programin dhe planin mësimor.</p> <p><i>Evidence 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>Evidence 1.7.1 Rregullore e departamentit të STM</i> <i>Evidence 1.8 Rregulloria e programit të studimit STM</i> <i>Evidenca 4.12 Rregullorja e EMS</i> <i>Evidenca 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen web</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Njësia bazë, është përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Programi ka gjithsej 60 kredite 1500 orë. Program është i ndarë në 2 semestra. Lëndët janë të ndara në module të ndryshme sipas karakterit të disiplinës (A-E). Nga 1500 orët, 339 janë leksione, 166 seminare, 118 laboratore dhe 877 studim individual. Informacion po ashtu i detajuar gjendet edhe në syllabuset e cililit modul. Njësia kryesore/bazë, është përgjegjëse, për ndarjen e ngarkesës mësimore dhe mbarëvajtjen e saj.</p>

	<p><i>Evidencë 2.9: Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p> <p><i>Evidencë 2.12 Syllabuset</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në përfundim të ciklit të studimit 1 vjeçar studenti pajiset me diplomë universitare Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale". Ky program studimi mbështetet në strategjinë institucionale të UNIEL, të zbatuar konkretisht për studimet në fushën e Infermierisë, si dhe përmbushjen e objektivave strategjike institucionale, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Në kurrikul pëfshihen lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese të programit, lëndë plotësuese si edhe lëndë ndërdisiplinore/, me një total prej 60 kredite (ECTS), konform parashikimeve ligjore për programet e ciklit të dytë të studimeve. Në rregulloren e programit të studimeve (neni 20) përfshihet informacion mbi politikat e pranimit, procedurat e pranimit (neni 21) dhe dokumentacioni i pranimit (neni 22). Në rregulloren e Departamentit përfshihet informacion i detajuar mbi transferimin e studimeve (neni 44) si dhe njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve (neni 43). Në vendimin e Senatit Akademik mbi kriteret e pranimit përfshihen po ashtu kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit të STM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregulloria e programit të studimit STM</i> <i>Evidencë 1.8.2 Vendimi i miratimit të kriterëve të pranimit</i> <i>Evidencë 2.9: Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në syllabuset e paraqitura, të programit të studimit shihet se ato përmbajnë informacionet e nevojshme për lëndën përkatëse (syllabuset janë të detajuara) për secilën lëndë. Mungojnë syllabuset e praktikave, seminarin apo orët e praktikës, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. Ajo që u vu re nga GVJ është se në syllabus nuk paraqiten temat e praktikës që bën studenti në praktikën klinike. Paralelisht u vërejt se forma e syllabusve nuk është e njëjtë ndërsa një pjesë e tyre nuk kishin objektivat e mësimnxënies si dhe rezultatet që priten nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e studimeve të FSHMT-së</i> <i>Evidencë 2.12 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Institucioni referon se përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program, si dhe kreditet për secilën prej tyre rishikohen në mënyrë periodike. Ndryshimet propozohen nga Departamenti, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni, por edhe nga anëtarë të personelit akademik, në konsultim me aktorë të tregut të punës, si përgjigje ndaj</p>

	<p>kërkesave të tregut të punës dhe dinamikave të brendshme. Propozimi për ndryshime në çdo rast vjen i argumentuar nga pala e interesuar. Ai shqyrtohet në Departamenti dhe nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe pastaj dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe i përcillet Senatit për miratim të mëtejshëm. Si rregull, rishikimi mund të bëhet vetëm para fillimit të vitit akademik dhe jo në mes të vitit akademik apo pasi ai të ketë filluar. Rishikimi i programit mund të parashikojë bashkime lëndësh ose ndarje të tyre, por pa cenuar raportet e përcaktuara për secilën kategori disiplinash në program, rishikimin e krediteve të lëndëve, të teksteve që do të përdoren por edhe të literaturës. Nëse, pas rishikimit të programit të studimit, në Kategoritë A, B dhe C shtohen disiplina të reja, studenti që ka nisur studimet me programin e vjetër është i detyruar t'i frekuentojë ato nëse nuk ka plotësuar numrin e nevojshëm të krediteve në këto kategori. Në çdo rast, ndryshimet nuk mund të jenë të tilla që të devijojnë nga formimi i kërkuar për fushën përkatëse të studimit. Komente dhe sugjerime vin edhe nga Urdhëri i Infermierit siç u përmend nga Presidentja e Urdhërit gjatë takimit me stafin akademik. Sipas diskutimeve në takimet e GVJ, mungesa e studenteve evidenton mos përfshirje të tyre në këtë proces.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e studimeve të FSHMT-së</i> <i>Evidencë 2.12 Programet mësimor të lëndëve të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2.9, Plani mësimor</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i> <i>Takim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni;</i></p>								
Konkluzione	<p><i>I gjithë informacioni për programin e studimit është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Programi i studimit përmban të gjithë elementët përfshirë planin mësimor, modulet, syllabuset etj. Përpjekje për përmirësimin e programit të studimit por nuk u prezantua dokumentacion konkret mbi këtë gjë ndërsa studentët raportuan si jo të përfshirë në këtë proces. Sipas mendimit të GVJ ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="544 1469 754 1541"></th> <th data-bbox="754 1469 938 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="938 1469 1150 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1150 1469 1378 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="544 1541 754 1585"></td> <td data-bbox="754 1541 938 1585"></td> <td data-bbox="938 1541 1150 1585" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1150 1541 1378 1585"></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

<p>Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave,</p>	<p>Nisur nga fakti që studentët e këtij programi kanë një formim të përgjithshëm në Bachelor Infermieri në shpërndarjen e moduleve nuk ka ndonjë kriter specifik varësie nga moduli në modul. Modulet/ lëndët janë</p>

<p>mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>të sistemuara në mënyrë të tillë që të sjellin një formim llogjik të studentit duke filluar me module klinike dhe praktike. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit në Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” janë konceptuar e hartuar me qëllimin e thellimit të njohurive dhe aftësive për një kujdes më të avancuar të pacientët si edhe për studime më të thelluara si në auditor dhe praktika brenda vendit ndërsa institucioni referon se praktikantët janë kryer dhe jashtë vendit. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se nuk ka thellim të njohurive dhe ka një përsëritje të atyre që janë zhvilluar në bachelor. Mungesa e studentëve në këtë program e bën të vështirë vlerësimin.</p> <p><i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT-së</i> <i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mësimor</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët janë të ndara të pasqyruara me (ECTS) përkatëse. Një kredit është 25 orë mësimore, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, laborator, praktikë dhe provim) dhe orë për punë të pavarur të studentit. Në total ka 1500 orë, ku leksione ka 366 orë seminare 166, laborator 118, në total ka 1527 orë. GVJ vlerëson të rishikohet.</p> <p>Lëndët janë të shpërndara në dy semestra, ku formimi terori dhe ai praktik mundëson formimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor mundëson realizimin e objektivave formues të programit të studimit dhe arritjen e kompetencave të studentit në njohuri më të thelluara.</p> <p><i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT-së</i> <i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Në pogramin e studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” (MPIK) rezulton, se raporti teori praktikë është i përafërt me programet ndërkombëtare dhe kjo vërehet në njëhësimin e diplomave dhe planit në përputhje me profilin e mësimor që bëjnë në studentet të cilët punojnë në vende të ndryshme të programit të studimit dhe e përafërt botës. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare, ndryshime të vogla ka vetëm në numrin e ECTS për lëndë. U deklarua se ky program është i ngjashëm me programin i cili ofrohet në Universitetin Aquila në Itali. Pavarësisht këtyre më lart, mendojmë se duhet të rritet numri i orëve të praktikës. Sipas programit të studimit dhe takimeve të zhvilluara ky program siguronë aftësi, kompetenca dhe</p>


	<p>formim të thelluar profesional.</p> <p><i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT-së Profesional", Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit MPIK</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" përfshin veprimtari formuese dhe plani mësimor parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, midis formimit teorik dhe praktik duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në qendra spitalore. Transferimi i studimeve është i mundur ndërsa mobilitetet jashtë Shqipërisë në këtë program studimi është i mundshëm.</p> <p>Bazuar në lëndët specifike, programi i paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxnies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në përfundim të studimeve, në kurrikulën e tij mundësi praktike në spital dhe ambulancë. Në përfundim të studimeve, studentët kanë mundësi të punësohen në spitale ose qendra ambulatorie. Studentët e përfshirë në takim nuk kishin eksperiencë mobiliteti jashtë apo transferim të studimeve. Po ashtu studentët në këtë takim nuk ishin pjesë e këtij programi studimi. Transferimi i studimeve është i mundur sipas parashikimeve në rregulloren e Institucionit si dhe atë të Departamentit.</p> <p><i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT-së Evidencë 1.4 Rregullore e Institucionit Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit MPIK Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit MPIK Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse, kryesisht të 5 viteve të fundit. Në mënyrë të vazhdueshme, ato duhet të përmbajnë aftësi dhe kompetenca në përputhje me njohuritë që merr studenti. Institucioni referon se çdo vit dorëzohen në Departament një kopje e ciklit të leksioneve apo librit që do të përdoret. Lista e literaturës së detyruar dhe të rekomanduar evidentohet në syllabusin e lëndës, duke përfshirë literaturën. Në syllabuset e dorëzuar vërehet një mos përditësim i literaturës në disa raste si dhe përdorimi i formateve të ndryshme. Po ashtu, në disa raste mungon viti i hartimit të ciklit të leksioneve.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit të STM Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit MPIK Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit MPIK Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit synon të ndihmojë studentët në përfundimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim arritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat duhet të përputhen me përmbajtjen e ciklit të dytë. Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</p>


	<p>garanton përfimin e këtyre kompetencave duke i ofruar studentëve njohuri dhe dije të thelluara dhe specifike në fushën e Infermierisë. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe klinike.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit të STM</i> <i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit MPIK</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mesimor i programit të studimit MPIK</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” i mundëson vijimin e njohurive të studentëve në trajnime të mëtejshme konferenca specifike në këtë fushë si dhe njohuri të mëtejshme të studimeve. Studentët të cilët përfundojnë këtë cikël studimi nuk kanë mundësi për të aplikuar për studime doktorale. Niveli i njohurive është në përputhje dhe i jep mundësinë studentëve të punësohen. Lëndët që zhvillohen dhe programet lendore të tyre krijojnë tek studentët një bazë shumë të mirë profesionale për punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë 1.3 .1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT-së</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mesimor i programit të studimit MPIK</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit në Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” janë konceptuar e hartuar me qëllimin e thellimit të njohurive dhe aftësive. Lëndët/modulet janë të shpërndara në 2 semestra dhe secila me kredite specifike. Syllabuset përditësohen sipas diskutimit gjatë takimeve por në disa raste është parë një mos përditësim i tyre. Programi u ofron mundësi studentëve të përmirësojnë aftësitë dhe kompetencat e tyre. Sipas mendimit të GVJ ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe</p>	<p>Institucioni referon se për përmirësimin dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës njësia bazë merr në konsideratë informacionet e marra nga takime me institucionet akademike, shëndetësore vendase dhe të huaja si në lidhje me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit. Pjesë e madhe e stafit akademik janë alumni të UNIEL dhe ata vazhdimisht kontribuojnë në përmirësimin e programit. Paralelisht, në takim,</p>

M. 



<p>marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Presidentja e Urdhërit të Infermierit informoj që zhvillon takime dhe informon mbi nevojat e tregut të punës. Institucioni ka ngritur me këtë qëllim dhe Bordin Këshillimor të Biznesit por që nuk kishte përfshirje në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e Marreveshjeve të Bashkepunimit</i> <i>Evidencë 1.12.2 Raportit i analizës vjetore të Departamentit 2020-2021</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në strukturat e ndryshme si dhe në komisionet që ngrihen është një detyrim ligjor. Pjesmarrja e studentëve në Senatin Akademik u jep atyre mundësinë të propozojnë përmirësime të programit të studimeve. Studentët kanë Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Paralelisht, sipas takimeve të zhvilluara, ata kanë dhe një kryetar grupi i cili përcjell shqetësimet e tyre për çështjet e përditëshme por jo për përmirësimin e programit të studimeve. Qëndrimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilesisë së këtij programi studimi është i mundur edhe përmes pyetësorëve që organizohen nga strukturat e UNIEL apo edhe fakulteti dhe departamenti. Pyetësorët, si instrumente matëse të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve, shërbejnë përmes të dhënave të tyre, për të nxjerrë probleme e sugjerime në lidhje me programin e studimit dhe përmirësimin e tij. Një pjesë e studentëve në këtë program studimi të cilët punojnë si infermierë të licensuar në institucione të shërbimeve shëndetësore janë përfshirë vazhdimisht në diskutime në lidhje me programin e studimit si dhe një pjesë e tyre janë pedagog të jashtëm. Praktikë specifike për përmirësimin e programit nuk u prezantua ndërsa studentët që morrën pjesë në takim deklaruan se nuk janë përfshirë në procedura të përmirësimit të programit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik UNIEL</i> <i>Evidencë 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor</i> <i>Evidencë 5.17 Rregullore për funksionimin të përhershëm për studentët dhe këshillimin e karrierës (link uniel.edu.al)</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet arsimore kanë në fokus jo vetëm shkëmbimin e stafit dhe studentëve për module të njejta, por edhe shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me përditësimin e programeve aktuale dhe organizimin e leksioneve të hapura për tematikat specifike. Pedagogët raportuan gjatë takimit se marrin parasysh zhvillimet e fundit në fushën e tyre dhe mundohen ti përfshin ato në leksionet që zhvillojnë. Presidentia e Urdhërit të Infermierit e cila morri pjesë në takim u shpreh se bashkëpunon ngushtë me institucionin me qëllim përmirësimin e programeve të studimit.</p> <p><i>Evidencë 3.10 Njoftim për orët e hapura</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni raporton se përditëson programin e studimit në bazë të nevojave të tregut duke përfshirë instrumenta të ndryshëm përfshirë këtu pyetësorët për studentët apo takimet me Urdhërin e Infermierit. Studentët me përfaqsimin e tyre në Senatin Akademik si dhe përmes</i></p>

	<i>Këshillave Studentor përfshihen në këtë process. Studentët e përfshirë në takim, raportuan mos marrje pjesë deri më sot. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Prioriteti i programit të studimit është formimi i studentëve të aftë për të qënë kompetent në fushën e tyre. Programi përcakton qartë prioritetet dhe përgjegjësitë në menaxhimin e situatave komplekse jo vetëm si profesioniste por objektivat kryesorë të studimit dhe edhe me vlera të larta humane. Misioni i këtij programi studimi është përgatitja e specialistëve / profesionisteve teknikë me njohjen dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, etj. në organizimin e punës në drejtim të rritjes së kosto-efektivitetit të tyre, përdorimin më të mirë të burimeve njerezore, minimizimin e gabimeve mjekesore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor që i ofrohet pacientit me gjithë gamen e ekzaminimeve. Programi Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ka për objektivi t'u japë pjesëmarrësve aftësi profesionale në sallën kirurgjikale. Programi ka për objektivi të rrisë kompetencat profesionale të infermiereve nepërmjet njohjes më të plotë të protokolleve të punës në sallë, interpretimin diagnostik të analizave dhe përshtatjen bashkëkohore me teknologjinë e kohës. Kërkimi shkencor është një objektivi po ashtu kryesorë e këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.3 Strategjia e zhvillimit të UNIEL</i> <i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit të MPIK</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit MPIK</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia Kryesore si dhe Njësia Bazë realizon kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Pedagogët e UNIEL kanë liri në mësimdhënie si dhe në veprimtari kërkimore shkencore. Njësia organizon dhe administron procesin akademik duke nxitur, bashkërenduar dhe respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturës etj. Dekani i Fakultetit ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit. Shpërndarja gjatë vitit akademik e orëve të teorisë dhe projekteve kërkimore dhe praktikave bën të mundur ndërthurjen e dijeve dhe siguron mundësinë për të respektuar lirinë akademike të pedagogut, duke ndihmuar studentët në mbledhjen e të dhënave klinike për të prezantuar raste konkrete të hasura në fushën e studimit, në projektet e tyre lëndore.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL</i></p>

	<p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7. 1 Rregullore e DSTM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit MPIK</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Institucioni referon që Departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca, seminare dhe ëorkshope si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, nëpërmjet detyrave të kursit, dhe hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Sipas rregullores së Departamentit, studenti ka të drejtë të perdorë, sipas rregullave përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron shkolla për të realizuar programin mesimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor (neni 58). Paralelisht, studentët e MPIK kanë të drejtë të përdorin pajisjet e institucionit sipas rregullave përkatëse për të realizuar programin mesimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tyre mesimor, profesional etj. (neni 24). Produktet shkencore të studentëve, si dhe temat e kursit, depozitohen në menynë elektronike dhe të printuar pranë departamentit dhe shërbejnë si të dhëna kërkimore dhe nga ana tjetër, pedagogët i kanë nxitur studentët t'i botojnë këto punime, i kanë përfshirë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në UNIEL dhe në botimet të Buletinit të UNIEL. Paralelisht, vjet është zhvilluar konferenca e parë ndërkombëtare e studentëve dhe sivjet parashikohet të organizohet e dyta. Pedagogët gjatë takimit raportuan se kanë përfshirë studentë në punën e tyre kërkimore dhe kanë publikuar në Buletinin e UNIEL.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7. 1 Rregullore e DSTM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit MPIK</i> <i>Evidencë 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021 -2022</i> <i>Evidencë 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL</i> <i>Tabela 22 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni referon se mbështet financiarisht aktivitetet studimore, kërkimore e shkencore në bazë të buxhetit të miratuar. Organizimi i konferencave është një metodë e mbështetjes së këtyre aktiviteteve. Në takimin me stafin akademik u theksua se nuk kanë marrë mbështetje financiare nga Institucioni për pjesmarrje në konferenca ndërkombëtare ose për publikim artikulli shkencor. Njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe ajo nuk administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p> <p><i>Evidencë 2.3 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022</i> <i>Evidencë 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike Buletini UNIEL</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit janë të përcaktuara qartë. Njësitë realizojnë kërkim shkencor në bazë të fushës së vet si dhe duke respektuar etikën në kërkimin shkencor. Studentët përfshihen në aktivitete kërkimore shkencore ndërsa stafi raporton mungesë mbështetje financiare për kërkimin shkencor. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	presisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi II.7
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Institucioni referon se mbledhja e të dhënave kërkimore të studentëve në funksion të detyrave lëndore mbështet projektet e lëndëve dhe që plotësojnë kuadrin e objektivave të masterit. Projektet kërkimore-shkencore kryhen në struktura mbështetëse dhe departamente të tjera dhe që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. Këto të dhëna pedagogët referojnë se studentët mund ti mbledhin në qendrat spitalore me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi. Nga diskutimi u raportua se FSHMT ka projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI por jo nga burime Europiane. Rritja e nr. të projekteve kërkimore shkencore është e nevojshme për Njësinë Bazë.</p> <p><i>Evidencë 1.3.1 strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Institucioni referon se Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekësore angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigjur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore, kërkesave për analiza, studime dhe projekteve me karakter kërkimor. Personeli akademik realizon modele bashkëpunimi afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. Njësia bashkëpunon po ashtu edhe me Institucione homologe me qëllim kërkimin shkencor. Pedagogë të huaj marrin pjesë në mësimdhënie si dhe organizojnë leksione të hapura. Këto aktivitete rrisin mundësitë e zhvillimit të kërkimit shkencor. Paralelisht, Njësia inkurajon pedagogët të marrin pjesë në mobilitete afatshkurtra jashtë vendit përmes programit Erasmus+. Përmes këtij programi një numër i konsiderueshëm i stafit akademik ka zhvilluar mobilitete jashtë shtetit gjë që i kan ndihmuar ata në aktivitetin kërkimor. Aplikime në projekte kërkimore shkencore me partner të brendshëm dhe të huaj u raportua nga Drejtuesit e FSHMT dhe DSTM se janë zhvilluar.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>Evidencë 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i> <i>Evidencë 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit të FSHMT</i> <i>Evidencë 3.10 Lajmërim për një orë të hapur</i> <i>Evidencë 6.4 Lista e personelit të ftuar të angazhuar në FSHMT</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose</p>	<p>Departamenti mbështet realizimin e konferencave ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale si dhe organizon aktivitete të ndryshme ë cilat ndihmojnë personelin akademik dhe studentët. Studentët kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnuese ndërsa personeli ka mundësinë</p>

aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arrijtjen e objektivave.	të marri pjesë në leksione të hapura si dhe aktivitete të ndryshme. <i>Evidencë 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT</i> <i>Evidencë 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i> <i>Evidencë 3.10 Lajmërim për një orë të hapur</i> <i>Evidencë Tabela 19 Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik në kuadër të programit të studimit</i> <i>Takim me stafin akademik</i>						
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Institucioni referon se programi i studimit formon profesionistë konkurrues për një gamë të gjerë të patologjiive me të hasura klinike duke i bërë infemierët të aftë për tregun kombëtar dhe të përshtatshëm të punojnë në çdo qëndër shëndetësore dhe gjithashtu të synojnë edhe tregun ndërkombëtar të punës. Një pjesë e madhe e punonjësve të spitalit janë alumni të FSHMT ndërsa një pjesë e madhe e të diplomuarve kanë ikur jashtë Shqipërisë. <i>Evidencë 5.7 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarveve 2020-2021</i>						
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Institucioni referon që nuk është kompetencë e Departamentit të Specialiteteve Teknike Mjekesore. Sipas takimit me stafin akademik, Presidentia e Urdhërit të Infermierit raportoi se ka një përqindje të lartë të diplomuarve të FSHMT të cilët marrin licensën. <i>Takim me stafin akademik</i>						
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në vizitën e GVJ, Institucioni referon se, përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian.						
Konkluzione	<i>Aktivitete kërkimore shkencore zhvillohen ndërsa Departamenti i Specialiteteve Teknike Mjekësore angazhohet për të lidhur dhe për t'iu përgjigjur marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore. Departamenti mbështet realizimin e konferencave dhe aktiviteteve kërkimore ndërsa të diplomuarit janë konkurrues për tregun e brendshëm dhe të jashtëm. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Mach

Dustaj

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i eksperiëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Institucioni ndjek një politikë të qartë si dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. Të gjitha lëndët e ofruara janë të detyrueshme. Gjatë ciklit të dytë të studimeve, studenti duhet të thellojë njohuritë dhe aftësitë në fushën e studimit. Gjithashtu Institucioni ka hartuar dhe detyrat e tutoriatit akademik, si duhet të plotësojë interesat të veçanta studimore të studentit përmes profilit të zgjedhur. Orët e mësimin i përshtaten natyrës së lëndëve me qëllim angazhimin e të gjithë studenteve në synimin e arritjes të një nxënie efikase. Për të pasur një përvetësim sa më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, praktikatat profesionale, role play, case study, etj. Një tjetër aspekt të cilit i është kushtuar rëndësi është organizimi i leksioneve të hapura. Institucioni referon se Departamenti zhvillon leksione të hapura me ekspertë të fushës të shëndetit në përgjithësi. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm, përgjatë gjithë semestrit, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të identifikojnë mangësitë dhe t'i plotësojnë ato përpara përfundimit të semestrit.</p> <p><i>Evidenca 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirugjikale"</i></p> <p><i>Evidenca 2.12 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni referon se, personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke operuar me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies me qëllim gjithëpërfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime që organizohen nga personeli akademik për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve si dhe për të konsultuar lidhur me temën e diplomës. Në bazë të programit të studimit, duke patur parasysh që është program i studimit Master Profesional në "Infermieri Kirugjikale" si dhe feedback e marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies përveç atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, projekte studimi në grup, mjete audio-vizive, metodat e simulimit, role-play etj. Në vizitën e zhvilluar në FSHMT, klasat ishin të pajisura me mjete bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit</i></p> <p><i>Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit MPIK</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik</i></p> <p><i>Vizitë në ambientet e FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet</p>	<p>Në vizitën në institucionin të GVJ, Institucioni referon se mbështet dhe</p>

<p>personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet.</p>	<p>ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademikë pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave didaktike. Në universitetet partnere, pedagogët kanë mundësi të trajnohen si dhe të zhvillojnë leksione. Institucioni nuk ka ndonjë plan specifik edhe/ose udhëzues për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit.</p> <p><i>Evidencë 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i> <i>Evidencë 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personeleve</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxiti te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Instituciononi referon se, ka të përcaktuara kriteret e detajuara për rekrutimet e personelit të angazhuar në mesimdhënien akademike si atë me kohë të plotë, por dhe atë me kohë të pjesshme. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie nëse është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, në vizitën që u bë në Institucion pedagogët referuan që mundoheshin ta zhvillonin leksionin në mënyrë interaktive me diskutime me referime të ndryshme. Paralelisht, studentët vlersojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Studentët raportuan se gjatë leksioneve ata marrin pjesë në mënyrë aktive ndërsa pedagogët i përfshin në diskutime për çështje të lëndës.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjeksore</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit STM</i> <i>Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UNIEL organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve/programit të studimeve. Në bazë të këtij aktiviteti merren masa të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Paralelisht, rezultatet e arritura në provime është një mekanizëm tjetër me qëllim vlerësimin e mësimdhënies. Pavarësisht këtyre, nuk u përmendën aktivitete specifike të tjerë për përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 1.12.2 Raport vjetor i veprimtarise se departamentit per vitin 2021 -2022)</i> <i>Evidencë 6.1.1 Raporti i pyetësorit institucional sezoni verës (Qershor 2022)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë</p>	<p>Institucioni referon se, ka në përbërje të tij struktura akademike dhe ndihmës akademike me qëllim funksione të ndryshme përfshirë këtu koordinimin institucional, projektet, cilësinë etj. Në takimet e zhvilluara këto struktura nuk raportuan aktivitete specifike për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Drejtoria e Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë raportoi aktivitete me zhvillimin e leksioneve të hapura dhe mobilitetin e pedagogëve. Nga ana tjetër, përfaqësuesit e Njësies së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë raportuan zhvillimin e pyetësorit si një nga aktivitetet</p>

përgjegjëse mbështesin . eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	kryesore për përmirësimin e mësimdhënies. Angazhimi më i madh i strukturave ndihmësakadematike është i nevojshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. <i>Evidencë 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i> <i>Evidencë 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI</i> <i>Takim me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</i> <i>Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrdhënieve me Jashtë</i>		
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një politikë të qartë si dhe harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Diversiteti respektohet dhe studentët kanë mundësi të zhvillojnë procesin mësimor në forma alternative. Studentët vlerësojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Mbështetja e strukturave duhet të jetë më e lartë ndërsa institucioni duhet të ndërtoj plan specifik edhe/ose udhëzues për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren e departamentit (nenet 31-41) përcaktohen qartë mënyra e kontrollit të dijeve dhe vlerësimi. Në rregulloren e programit të studimit neni 15 përcakton procedurat dhe kriteret e vlerësimit ndërsa neni 16 dhe 17 përcakton hyrjen në provim si dhe zhvillimin e tij. Nenet 18 dhe 19 përmbajnë informacion mbi vlerësimin dhe procedurën e komunikimit të vlerësimit. Po ashtu, informacion i detajuar mbi vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përfshihet edhe në syllabusin e secilit modul. Institucioni referon se, UNIEL zbaton prej disa vitesh dhe sistemin e automatizuar të testimit e vlerësimit të njohurive, korrigjimit të provimeve, në kuadër të projektit CLEANSCORE. Përsa i përket FSHMT, Institucioni referon që nuk ka filluar akoma implementimin e tij në këtë Fakultet. Mënyra e kontrollit të njohurive për cdo modul/lënde përcaktohet me rregulloren ku i referohet syllabusit përkatës, i cili u bëhet me dije studentëve që në fillim. Rregulloret janë të aksesueshme nga studentët dhe publiku në faqen zyrtare të UNIEL. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të elementëve të mëposhtëm: Për lëndët e Tipologjisë I a. Provimit përfundimtar (40%) b. Detyrave praktike: 2 (dy) x 30% = (60%)

	<p>Për lëndët e Tipologjisë II</p> <p>a. Provimit përfundimtar (40%)</p> <p>b. Provimit të ndërmjetëm (30%)</p> <p>c. Detyrë kursi I (20%) mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit te STM</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit te studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e programit MPIK</i> <i>Evidencë 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët, ata referuan se, në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulit në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format, informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Studentët po ashtu njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Studentët po ashtu pohuan se gjatë fillimit të moduleve/lëndëve pedagogu respektiv i informon ata mbi metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive. Nuk u përfshinë student të këtij programi në takimin e zhvilluar pasi programi nuk kishte student aktivë.</p> <p><i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Në UNIEL zhvillohen dy lloj provimesh, të ndërmjetme dhe përfundimtare. Provimet e ndërmjetme zhvillohen për lëndët në mes të semestrit, ndërsa provimet përfundimtare zhvillohen në fund të semestrit për secilën tipologji lënde. Provimet zhvillohen si rregull me shkrim. Në varësi të specifikave të lëndës, provimi mund të jetë dhe me gojë. Paralelisht, pedagogët në disa raste raportuan se gjatë zhvillimit të lëndës vlerësojnë studentët dhe performanca e tyre merret parasysh në notën përfundimtare të studentit. Po ashtu, disa pedagogë raportuan se u japin studentëve detyra kursi (individuale ose në grup) mbi të cilat ata vlerësohen.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve DSTM</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabus lënde</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen qartë në rregulloren e departamentit si dhe atë të programit të studimeve. Studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive ndërsa pedagogët përdorin mënyra të alternative të vlerësimit në bazë të përcaktimeve në syllabus. Sipas mendimit të GVJ, standardi</i></p>

	përbushet kryesisht.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në vizitën në Institucion dhe në takimet me Pedagogët dhe Studentët, GVJ mori përgjigjen se testimi i dijeve behet me anë të provimeve me shkri dhe me gojë gjë, si dhe me detyra kursi të bëra nga studentët. Kjo reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Studentët konfirmuan gjatë takimit se pedagogët ndjekin një metodologji të vlerësimin në vazhdimësi dhe ky vlerësim përfshihet në notën përfundimtare.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale</i> <i>Evidencë 2. 9 Programi mësimor i lëndëve të programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimin, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>UNIEL zbaton prej disa vitesh dhe, sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF. Por institucioni referon që FSHMT nuk e ka implementuar akoma këtë sistem. Implementimi i projektit CleanScore edhe në FSHMT është i nevojshëm.</p> <p><i>EVIDENCA 3.4 Marrëveshja për imlementimin e CLEANSCORE.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Institucioni referon që, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin si dhe sipas rregullores së studimeve të FSHMT, rregullores së Departamentit dhe rregullores së programit të studimeve. Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga një komision provimesh i përbërë nga të paktën 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Në përfundimin e provimit, pedagogu ka 6 ditë me qëllim korigjimin dhe informimin e studentëve. Sipas takimeve të zhvilluara, pedagogët zhvillojnë një procedurë ku pasi korigjiojnë provimet i mbledhin në klasë studentët dhe u komunikojnë rezultatet. Në rastet ku dikush nuk është i qartë u jepet informacion/feedback i detajuar. Në rastin që studentët nuk binden mund të vazhdojnë procedurën e ankimimit. Ky proces u konfirmua edhe gjatë takimit me studentët. Kjo procedurë nuk është e parashikuar në rregulloret e departamentit si dhe të programit të studimeve.</p>

	<p><i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Institucioni referoi se nuk kishte akses në kontrole plagjiature dhe se përdorimi i platformës academia.al nuk ishte më e aksesueshme për shkak të përfundimit të fjalëve për kontroll. Disa pedagogë raportuan se me qëllim shmangjen e plagjiaturës, në detyrat e kursit edhe/ose në temat e diplomave i ndajnë në pjesë në disa student me qëllim mos kopjimin si dhe mundohen vetë të kontrollojnë nëse ka plagjiaturë apo jo. Në klasë gjatë provimeve nuk lejohet dikush tjetër përveç pedagogut të lëndës si dhe monitoruesve (të paktën 2 persona). Në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë të paautorizuar. Gjithashtu, studentët duhet të lënë në një vend të vecantë sendet personale dhe ndonjë material tjetër mësimor e informativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë me lëndën e provimit. Telefonat celulare duhet të jenë të fikur. Rregulla të hollësishme të zhvillimit të provimeve përcaktohen në rregulloren përkatëse të studimeve. Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementëve të tjera vlerësuese. Institucioni po ashtu ka miratuar kodin e etikës në kërkimin shkencor.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e studimeve të FSHMT</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve të DSTM</i> <i>Evidencë 6.5 Kodi i etikës në UNIEL</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Institucioni referon se dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 6 (gjashtë) ditëve nga data e zhvillimit të provimit, brenda të cilave përfshihen edhe seancat përkatëse sqaruese dhe hedhja e tyre në sistemin EMS. Kjo shprehet në nenin 33-41 të rregullores së studimeve të DSTM. Temat e diplomës, sipas kësaj rregullore (neni 56), duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, jo më pak se dy javë përpara ditës së caktuar për mbrojtjen dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve DSTM</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas procedurës së parashikuar, pedagogët duhet të hedhin në sistemin EMS brenda gjashtë ditëve rezultatet e provimit (neni 37). Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, duke iu drejtuar Dekanit të fakultetit. Dekani vlerëson ankesën dhe merr vendimin përkatës. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të DSTM me një ankese me shkrim. Drejtuesi i DSTM vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe ngarkon komisionin me aktin përkatës, që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Ky vendim është i formës së prerë dhe depozitohet në njësinë bazë dhe sekretarinë mësimore. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem. Neni 38 pasqyron qartë këtë procedurë. Në takimet me Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë,</p>

	<p>pedagogët dhe studentët u raportua që nuk ka patur ndonjëherë ankesa dhe për këtë arsye nuk kishte një dokumentim të kësaj procedure. GVJ konstaton se koha që studentët kanë në dispozicion është shumë e vogël dhe do ishte mirë të zhvillohen korrigjimet përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e studimeve DSTM</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësië Bazë</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të DSTM me një ankese me shkrim. Drejtuesi i DSTM vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe ngarkon komisionin me aktin përkatës, që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Ky vendim është i formës së prerë dhe depozitohet në njësinë bazë dhe sekretarinë mësimore. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore dhe arkivohen. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem. Neni 38 pasqyron qartë këtë procedurë. GVJ konstaton se koha që studentët kanë në dispozicion është shumë e vogël dhe do ishte mirë të zhvillohen korrigjimet përkatëse.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit të STM</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik ndërsa Njësia Kryesore nuk ka ende në përdorim mënyra të automatizuara të vlerësimit. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Në raste ankesash studentët kanë mundësi të kërkojnë rishikim dhe të marrin feedback ndërsa procedura e ankimit është e mundshme. Koha që studentët kanë në dispozicion është shumë e pakët. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.



Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.

Programi i studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, si program studimi duhet të garantojë thellimin e njohurive dhe aftësive, po ashtu arritjen e kompetencave. Institucioni referon se ky program do të mundësojë studentëve formimin e njohurive, do të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të do të synojë në kërkimin shkencor të studentëve. Gjithashtu ky program zhvillon aplikimin e njohurive praktike, aftësitë kërkimore shkencore; si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit, me qëllim që ata të integrohen më së miri në tregun, e punës. Misioni kryesor i këtij programi studimi është përgatitja e

	<p>specialistëve / profesionistëve me njohjen dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, etj. në organizimin e punës në drejtim të rritjes së kosto-efektivitetit të tyre, përdorimin me te mirë të burimeve njerëzore, minimizimin e gabimeve mjekesore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor që i ofrohet pacientit me gjithë gamen e ekzaminimeve. Qëllimi kryesor i këtij programi është që të arrihet një përgatitje sa më profesionale për stafin Infermieristik që ti shërbejë të gjithë komunitetit nëpërmjet planifikimit, organizimit dhe drejtimit të stafit infermieror në mënyre që të përthithet dhe nga tregu i punës. Ky treg përveç kërkesave për infermier me Arsim të Lartë ka nevojë dhe për infermier të specializuar në specialitete të ndryshme të mjeksisë, për infermier profesional.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p> <p><i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Institucioni referon se, bazuar në planin mësimor, programi i studimit në Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" garanton zhvillimin e aftësive specifike në fusha të veçanta, si në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë dhe në burimet njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit. Në kurrikulat e programit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale", studentët zhvillojnë disa lëndë me zgjedhje si: Teori Komunikimi dhe Biostatistikë, që kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të tyre.</p> <p><i>Evidencë 2.9 Plani mësimor i programit të studimit "Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblyëse.</p>	<p>Pedagogët gjatë vizitës së GVJ, referojnë se, në fund të semestrit, pas mbarimit të lëndës pedagogu përveçse mundëson që studentët të arrijë aftësitë, gjithashtu dhe të njohin çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lënde. Pedagogu mund të ndalet edhe në elementet që kanë rezultuar "të vështirë" për studentet, gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsulta përpara provimit. Studentët gjatë takimit me ta referuan se lëndët/modulet kanë një volum të madh dhe që për ta është shumë e vështirë brenda një periudhe të shkurtër kohore ti mësojnë.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe</p>	<p>Pedagogët gjatë vizitës në institucion referojnë se, mësimdhënia kryhet mbi bazën e njohurive të marra, në mënyrë që të realizohet arritja e kompetencave. Këto njohuri referojnë se u jepen studenteve në auditor, laborator dhe praktikat profesionale. Kjo mënyrë didaktike i bën të</p>





<p>praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>mundur studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre. Praktikat gjithashtu mendojnë pedagogët rrisin njohuritë e studentëve. Një rol tjetër komentojnë pedagogët, janë laboratorët që ata kanë në dispozicion. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në Praktikat profesionale të studentëve. Studentët gjatë takimit konfirmuan qasjen pozitive dhe klimën e përshtatshme nga pedagogët gjatë procesit mësimor. Syllabuset po ashtu përfshijnë (por jo të gjithë) kompetencat e fituara të mundshme në përfundim të lëndës/modulit. Kërkimi shkencor është po ashtu objektiv e pedagogëve. Ata kryejn studime të ndryshme me apo pa prezencën e studentëve. Paralelisht, Institucioni ka një numër të lart marrvëshjesh me Institucione jashtë vendit për të mundësuar mobilitetet e studentëve.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Evidencë 1.13 Marrëveshja e bashkëpunimit me institucionet</i> <i>Evidencë 1.15 Komiza konceptuale e programit të studimit</i> <i>Evidencë 3.1 Lista e marrvëshjeve të bashkëpunimit Erasmus+</i> <i>Evidencë 3. 9 Stratealia e zhvillimit të mobilitetin e studenteve.</i> <i>Programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni referon se, dpartamenti herë pas here zhvillon leksione të hapura dhe ëorkshope nga personel efektiv dhe me kontratë me tema të caktuara, mbi zhvillimet e reja të shkencës dhe seminare mbi zhvillimet e reja të teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. Këto aktivitete u japin mundësi stafit pjesmarrës dhe studentëve të informohen mbi aspekte të reja të shkencës, metodologji të reja etj.</p> <p><i>Evidencë 3 .10 Njoftim për një orë të hapur</i> <i>Takim me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Për zhvillimin e këtij programi studimi, praktika profesionale ka një rol kryesor. Institucion dhe pedagogët e departamentit mbështesin studentët në idetë e tyre si dhe në kërkime shkencore. Sipas takimeve të zhvilluara pedagogët referojnë së ata përfshijnë studentët në realizimin e kërkimeve shkencore dhe në disa raste, rezultatet janë të publikuara në Buletinin e UNIEL. Pedagogët po ashtu raportojnë se nuk kanë mbështetje financiare nga Instiucion për kërkim shkencor përveç rasteve të konferencave të cilat organizohen nga vet UNIEL.</p> <p><i>Evidencë 2.3 Miratimi i Buxhetit</i> <i>Evidencë 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL, Buletini Shkencor.</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit MPIK garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në</i></p>

	<p><i>përfundim të lëndës. Syllabuset jo të gjithë përfshijnë kompetencat e fituara të mundshme në përfundim të lëndës/modulit. Leksione të hapura dhe ëorkshope zhvillohen periodikisht. Studentët përfshihen në kërkime shkencore por pedagogët raportojnë mos mbështetje financiare nga Institucioni. Sugjerohet që në programin mësimor të përfshihet edhe lënda/moduli i "Informatikës Shëndetësore". Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>UNIEL ka hartuar rregulloren e studimeve. Procedura e detyrimeve përmbyllëse para realizimit të tyre dhe bërjes së tyre publike për studentët e FSHMT është e parashikuar në rregulloren e FSHMT-së, në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën e punimit të diplomës. Studentët njihen me këto rregullore në fillim të studimeve. Për të fituar diplomën në Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale" studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar, në përputhje me kreditet e percaktuara në planin mësimor. Për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mesimore dhe në praktikë, duke marrë kreditet e nevojshme (neni 14). Institucioni ka hartuar dhe një manual specifik për hartimin e diplomës. Rregullorja është publike në faqen zyrtare si dhe studentët informohen për këtë nga koordinatori i programit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p> <p><i>Evidencë. 3.5 Manual i punimit të diplomës për programin e studimit (rregulloria e diplomimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në bazë të përcaktimit të Rregullores së programit të studimeve dhe personeli akademik asistojnë studentët gjatë studimeve. Drejtuesi i Departamentit është personi përgjegjës i cili, bashkërendon punën për hartimin dhe përmirësimin e rregullores. Ai vë në dispozicion informacione, për programin e studimit për përgatitjen e planit mesimor dhe praktikës. Departamenti kujdeset që studentët të pajisen dhe informohen me të gjitha detyrimet përmbyllëse. Dokumentacionin udhëzues në lidhje me përmbushjen e detyrimeve përmbyllëse prezantohen në rregulloren e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale".</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në "Infermieri Kirurgjikale"</i></p> <p><i>Evidencë. 3.5 Manual i punimit të diplomës për programin e studimit</i></p>

<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p><i>(rregulloria e diplomimit)</i></p> <p>Vleresimi final i studentëve bëhet përmes administrimit të provimit final të diplomës, i cili bazohet në testimin e njohurive. Këtu prfshihen të gjitha lëndët/modulet në bazë të aftësive individuale të studentit. Për të fituar diplomën në Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar, në përputhje me kreditet e percaktuara në planin mësimor. Për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mesimore dhe në praktikë, duke marrë kreditet e nevojshme (neni 14). Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomes / të japë provimin përfundimtar të formimit pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planin mësimor të programit perkatës të studimit (neni 52).</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 3.5 Manual i punimit te diplomës per programin e studimit rregulloria e diplomimit</i> <i>Evidencë 3.13 Procesverbal i provimit të formimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmblyës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>UNIEL ka miratuar dhe formatin e punimit të diplomës dhe Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit. Udhëheqësi e asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve. Sipas takimit me pedagogët, disa nga ata, temën e diplomës e ndajnë në disa student (fushat e ndryshme) me qëllim të përfshihen në punë në grup si dhe të minimizojnë plagjiaturën. Nga studentët që marrin pjesë në takim, asnjë nga ata nuk kishte punuar temë diplome.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”</i> <i>Evidencë 3.5 Manual i punimit te diplomës per programin e studimit (rregulloja e diplomimit)</i> <i>Takim me stafin akademik</i> <i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>UNIEL asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve për kryerjen e matjeve, në mjediset e institucionit apo jashtë tij. Këto aktivitete lidhen me organizimin e ekspeditave studimore për studentët. Gjatë takimeve, u referua se studentët asistohen për mbledhje të dhënash në spital apo qendra shëndetësore me qëllim detyra kursi. Kjo u referua nga pedagogët por edhe studentët gjatë takimeve. Paralelisht, studentët kanë mundësinë të përdorin kapacitetet e FSHMT për të zhvilluar tema të ndryshme në bazë të fushës.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marreveshjeve të bashkapunimit Evidencë 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës,</p>	<p>Në përfundim të provimit përfundimtar studenti vlerësohet me notë. Në programin e ciklit të dytë të studimit "MPIK" studenti diplomohet me provim përfundimtar formimi ose punim diplome. Ka të drejtë të</p>

<p>studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>diplomohet, duke përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome, studenti i cili e ka mesataren e ponderuar të vitit të parë të studimit më të lartë se 8 ose një kufi më i lartë i vendosur nga njesia bazë. Vleresimet përfundimtare të lëndës/modulit dokumentohen në procesverbalin e provimit dhe në Regjistrin e notave.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të vlerësohet me notë UINIE</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Studimit e FSHMT-së</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit</i></p>						
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve në programin e studimit Master, studenti pajiset me Diplomën Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale”, si dhe suplementin. Neni 57 i rregullores së departamentit përcakton se në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën ose çertifikatë përkatese. Elementet përbërese, foma e diplomes dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Diplomat që lëshohen në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë, shoqerohen me suplementin e diplomës.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit</i></p>						
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>UNIEL ruan dokumentacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përveç akteve ligjore e nënligjore, UNIEL ka hartuar dhe një Rregullore specifike për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani".</p> <p><i>Evidencë 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka hartuar procedura të posaçme për detyrimet përmblyëse ndërsa studentët asistohen nga struktura respective si dhe pedagogët për informimin e tyre. Punimi i diplomës ka një format të përcaktuar qartë ndërsa dokumentacioni ruhet conform legjislacionit në fuqi. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes sëstandardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="582 1462 767 1541">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="767 1462 963 1541">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="963 1462 1187 1541">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="582 1541 767 1594"></td> <td data-bbox="767 1541 963 1594" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="963 1541 1187 1594"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë



Institucioni referon se Departamenti STM, bashkëpunon me aktorë të rëndësishëm në funksion të mësimdhënies për praktikën profesionale. Paralelisht, nga vizita në terren laboratorët janë në funksion të

mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	studentëve. <i>Evidencë 1.13 Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.14 Lista e marrveshjeve për zhvillimin e praktikave</i> <i>Vizita në terren</i>								
Kriteri 2: Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni referon se ka nënshkruar marrëveshje të posacme për realizimin e bashkëpunim dhe partneritet, për praktikat klinike dhe stazheve. <i>Evidencë 1.13 Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.14 Lista e marrveshjeve për zhvillimin e praktikave</i>								
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka 5 kredite gjithsej në një vit. GVJ mendon se praktika duhet të rishikohet për të rritur kreditet e saj. Në përfundim të zhvillimit të praktikave profesionale, studimet ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumentet e posacme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. Vlerësohet me notë. <i>Evidencë.14.2 Procesverbal i praktikave</i>								
Konkluzione	<i>Institucioni garanton mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikës duke bashkëpunuar me Institucione të tjera ndërsa paralelisht përdor ambientet e veta për punë laboratorike. GVJ mendon se praktika duhet të rishikohet për të rritur kreditet e saj. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem, GVJ konstatoi se Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Institucioni ka hartuar rregullore specifike për modalitetin e rekrutimeve të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Paralelisht, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore gjendet dosja e secilit nga anëtarët e departamentit ku përfshihet dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu CV-në e pedagogëve si dhe diplomat e fituara. Sipas takimeve në terren, personeli akademik mbulon në rastet më të shumta lëndë/module në bazë të studimeve si dhe të fushës kërkimore. Departamenti ka në përbërje të tij 8 pedagog me kohë të plotë (2 Prof. Asoc), (4 Dr. Shkencash), (1 PhD candidate) dhe 1 me Master Shkencor.</p> <p><i>Evidencë 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik</i> <i>Evidencë 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik</i> <i>Tabelat 1, 2, 6, 7</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar si dhe takimeve në terren, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit MPIK, mbulon ngarkesën mësimore sipas detyrimeve ligjore.</p> <p><i>Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidencë 2.13 Modeli i diplomës së programit</i> <i>Evidencë 2.15 CV-të e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit</i> <i>Evidenca 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik</i> <i>Tabela 2, 4, 12</i> <i>Takimi me Drejtuesin e Fakultetit dhe Departamentit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Universiteti ka depozituar pranë ASCAL dokumentacion i cili konfirmon qëndrueshmërinë e personelit akademik të këtij programi studimesh për periudhën e akreditimit. Dokumentacioni përfshin informacion mbi listëpagesën e personelit si dhe mbulimin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore. Ky informacion i depozituar në ASCAL përfshinë periudhën Janar-Qershor 2022. Paralelisht, FSHMT është fakulteti me nr. më të madh të studentëve gjë që rrit mundësitë për qëndrueshmëri afatgjatë.</p> <p><i>Evidencë 4.1 Listëpagesa e personelit Janar – Qershor 2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi,</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi bazuar në kritere të përgjithshme dhe specifike. UNIEL ka miratuar rregullore specifike</p>

<p>mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>të modaliteteve për rekrutimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe atij administrativ. Shpalljet për rekrutim bëhen publike ndërsa aplikuesit njoftohen mbi pikëzimin në bazë të kritereve të përcaktuara. Institucioni ndjek një procedurë standarte ku Departamenti përkatës vendos kriteret specifike për rekrutim në bazë të nevojave të programit dhe moduleve që do të trajtojnë. Departamenti i përcjell kërkesat e tij në dekanat dhe me pas dekanati i përcjell në Rektorat. Pas shpalljes, Rektori ngre një Komision vlerësimi të cilët janë anëtarë të Njesisë Kryesore ndërsa një përfaqësues i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore është prezent si vëzhgues i procedurës dhe pa të drejtë vote. Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka në dispozicion të gjithë informacionin nga shpallja deri në firmosjen e kontratës. Në statutin e UNIEL përcaktohen qartë po ashtu procedurat e punësimit (nenet 38-40)</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik</i> <i>Evidencë 4.3 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit ndihmës akademik</i> <i>Evidencë 4.4 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit administrativ</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion personel ndihmës akademik për realizimin e orëve laboratorike si dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe të mjediseve të tjera mësimore. Orët laboratorike zhvillohen nga personel i cili është në përputhje me nevojat e programit të studimit MPIK. Departamenti ka në dispozicion 2 personel ndihmës akademik (laborant). Neni 36 i statutit të UNIEL përcakton që Institucion siguron personel ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Tabela 2</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar. Drejtoria e Burimeve Njerëzore informon databasën mbi personelin akademik dhe ia përcjell sektorit të IT-së për shfaqjen në systemin EMS të Institucionit. Secili ka akses vetëm në informacionin e nevojshëm në bazë të statusit të tij (sekretare, pedagog, drejtues Njësie Bazë, Drejtues Njëie Kryesore). Pedagogët marrin akses në sistem ku përfshihen lëndët/modulet të cilat ata zhvillojnë nga Drejtuesi i Departamentit.</p> <p><i>Evidencë 2.15 CV-të e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit</i> <i>Evidencë 4.5 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa përkatëse</i> <i>Tabela 2, 12</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e</p>	<p>UNIEL për implementimin e këtij programi studimi ka marrëveshje me Institucionet përkatëse si Spitali Rajonal si dhe Spitali Psikiatrik. Studentët zhvillojnë praktikat e tyre nën mbikëqyrjen e pedagogëve të brendshëm/jashtëm. Pjesa më e madhe e pedagogëve të jashtëm janë personel i këtyre Institucioneve (spitaleve) dhe pjesa më e madhe e</p>






<p>mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>tyre janë të dilomuar në këtë Universitet. Në total 25 personel me kohë të pjesshme përfshihen në këtë program studimi për udhëheqjen e praktikave.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.14 Lista e marrveshjeve për zhvillimin e praktikave</i> <i>Tabela 1</i></p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli i angazhuar në realizimin e praktikave mësimore profesionale asiston studentët në zhvillimin e praktikës si dhe merr pjesë në vlerësimin e tyre sipas rasteve. Në takimet e zhvilluara nga GVJ, stafi akademik raportoi se studentët ndiqen në mënyrë të rregullt gjatë zhvillimit të praktikës (zakonisht nga staf me kohë të pjesshme) dhe kjo u konfirmua edhe nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marrveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>Evidencë 1.14 Lista e marrveshjeve për zhvillimin e praktikave</i> <i>Evidencë 1.14.1 Paketa e praktikës për programin e studimit</i> <i>Evidencë 2.9 Plani mësimor</i> <i>Tabela 1, 5</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe ka hartuar rregullore specifike për modalitetin e rekrutimeve të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik. Personel ndihmës akademik angazhohet në programin e studimit NDËRSA marrveshje bashkëpunimi me institucione të tjera janë në implementim. <i>Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin me qëllim kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike disponon tre godina. Godina e parë ka sipërfaqe 1382m² si dhe një sipërfaqe prej 845m² për sallat dhe laboratorët e mësimdhënies. Godina e dytë ka një sipërfaqe 360m² si dhe një sipërfaqe prej 248m² për sallat dhe laboratorët e mësimdhënies ndërsa godina e tretë 1208m² si dhe një sipërfaqe prej 783m² për sallat dhe laboratorët e mësimdhënies. Paralelisht, për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, Institucioni përdor edhe godinën e ish Maternitetit si dhe mjediset e spitalit Psikiatrik. Nga vizita në terren GVJ konstatoi se FSHMT ka ambiente të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p><i>Evidencë 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e FSHMT</i></p>

	<p><i>Evidencë 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratorëve të FSHMT</i></p> <p><i>Evidencë 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHMT</i></p> <p><i>Vizita në ambientet e FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sipas vizitës së zhvilluar në mjediset mësimore, klasat ishin të pajisura me mjete elektronike si video-projektor e perde për zhvillimin e mësimdhënies me përdorimin e mjeteve teknologjike të reja. Pedagogët përdornin zakonisht laptop-in e vet për implementimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e FSHMT</i></p> <p><i>Evidencë 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Laboratorëve të FSHMT</i></p> <p><i>Evidencë 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHMT</i></p> <p><i>Vizita në ambientet e FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Laboratorët e Njësisë kryesore përmbanin aparatura moderne dhe të përshtatshme për realizimin e moduleve me qëllim aftësimin praktik në bazë të objektivave të programit të studimit. Laboratorë të informatikës po ashtu ishin në dispozicion të studentëve me qëllim zhvillimin e lëndës së Biostatistikës. Pjesë e madhe e laboratorëve ishin përfituar falë projekteve dypalëshe me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë ose organizata/institucione të ndryshme.</p> <p><i>Vizita në ambientet e FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka në dispozicion për implementimin e këtij programi studimi disa laboratorë përfshirë këtu Laboratorin e Informatikës, Laboratorin dixhital të anatomisë, Laboratorin e Infermierisë, laboratorin e telemedicinës, etj. Këta laboratorë ishin të pajisur me pajisje bashkëkohore me qëllim implementimin e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHMT</i></p> <p><i>Vizita në ambientet e FSHMT</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar si dhe vizitës në terre, Institucioni ka mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi. Paralelisht, Institucioni ka marrëveshje me struktura spitalore (Spitalin Rajonal si dhe Spitalin Psikiatrik) për realizimin e programit të studimeve. Po ashtu, Institucioni zhvillon praktikat mësimore edhe në ambientet ambulatorë përfshirë këtu Qendrat Shëndetësore të qytetit.</p> <p><i>Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i></p> <p><i>Evidencë 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p>

M. Meri

Rastay



Konkluzione	<i>Institucioni ka siguruar kushtet dhe hapësirat, infrastrukturën fizike dhe logjistike për stafin me qëllim kryerjen e detyrave në procesin mësimdhënës dhe shkencor. Institucioni ka në dispozicion për implementimin e këtij programi studimi disa laboratorë përfshirë këtu Laboratorin e Informatikës, Laboratorin dixhital të anatomisë, Laboratorin e Infermierisë, laboratorin e telemedicinës, etj. Paralelisht, Institucioni ka marrveshje me struktura spitalore (Spitalin Rajonal si dhe Spitalin Psikiatrik) për realizimin e programit të studimeve. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni ka në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve literaturë fizike dhe digjitale. Pjesë e vogël e literaturës fizike gjendet në librarinë e Fakultetit si dhe atë qendrore të Institucionit ndërsa aksesit në library on-line është i mundur sidomos përmes ulibrary.al dhe JSTORE. Literatur fizike nuk ishte e pranishme në department. <i>Evidencë 2.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library Evidencë 2.8 Fondi i librit Evidencë 4.11.1 Blerjet e fundit të bibliotekës Vizita në terren</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Sipas takimit me pedagogët, ata përditësojnë literaturën e përdorur duke përdorur botime të viteve të fundit. Shumë botime nuk gjendeshin në mënyrë fizike në bibliotek ndërsa literatura e përdorur në syllabus ishte në disa raste e vjetër. <i>Evidencë 2.8 Fondi i librit Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve Evidencë 4.11.1 Blerjet e fundit të bibliotekës Vizita në terren</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve 2 biblioteka, ajo e Institucionit si dhe bibliotekën pranë Njesisë Kryesore. Bibliotekat kishin një numër librash, tekstesh mësimore si dhe publikime të ndryshme të cilat ishin në dispozicion të studentëve. Biblioteka e Njesisë Kryesore ishte në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premten nga ora 08:00 deri në orën 16:00 ndërsa ajo qendrorja nga ora 08:00-19:00 gjatë javës dhe 08:00-16:00 të shtunën. Oraret ishin të afishuara dhe jashtë bibliotekës. <i>Evidencë 4.11 Të dhëna mbi orarin e bibliotekës Vizita në terren</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e	Biblioteka, si ajo qendrorja edhe e Njesisë Kryesore ishte e pajisur me

M. [Signature]

[Signature]

<p>pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>tekste mësimore, literaturë ndihmëse si dhe publikime (sidomos të Buletinit të UNIEL edhe/ose aktiviteteve shkencore të organizuara) të cilat mbulonin pjesë të moduleve të programit të studimit. Shumë botime nuk gjendeshin në mënyrë fizike në bibliotek të cilat përdoren për programin mësimor.</p> <p><i>Evidencë 2.8 Fondi i librit</i> <i>Evidencë 4.11.1 Blerjet e fundit të bibliotekës</i> <i>Vizita në terren</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni u jep mundësinë studentëve të kenë akses në biblioteka on-line dhe pa kosto. Studentët kanë mundësinë të aksesojnë u-library e cila është vënë në dispozicion nga MAS ndërsa vet Institucioni përmes projektit CleanScore ka përfituar akses falas për të gjithë studentët në librarinë JSTORE. Në takimin me studentët ata raportuan mos njohje të këtyre mundësive për të aksesuar biblioteka on-line.</p> <p><i>Evidencë 2.7 Anëtarimi në JSTORE dhe U-Library</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Bibliotekat sipas vizitave të zhvilluara në terren ishin të pajisura me kompiutera në të cilat studentët kishin mundësi ti përdornin pa kufizim. Sipas takimit të zhvilluar, studentët kishin mundësi të aksesonin edhe bibliotekat on-line përmes kompjuterave të disponueshëm nga të cilës shkarkonin literaturën e nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 4.9 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK të FSHMT</i> <i>Vizita në terren</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Bibliotekat ishin në dispozicion të studentëve gjatë procesit mësimor si dhe përtej atij. Biblioteka e Njësisë Kryesore ishte në dispozicion të studentëve nga e hëna deri të premten nga ora 08:00 deri në orën 16:00 ndërsa ajo qëndronja nga ora 08:00-19:00 gjatë javës dhe 08:00-16:00 të shtunën. Oraret ishin të afishuara dhe jashtë bibliotekës.</p> <p><i>Evidencë 4.11 Të dhëna mbi orarin e bibliotekës</i> <i>Vizita në terren</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit</p>	<p>Nuk u vu në dispozicion të GVJ informacion specifik mbi ndjekjen dhe raportimit e cilësisë së fondit fizik dhe atij on-line të bibliotekës. Të dhëna mbi fondin fizik të bibliotekës janë dorëzuar pranë ASCAL ndërsa informacion mbi shfrytëzimin e këtij fondi nga personeli akademik dhe studentët gjendet në raportin vjetor të institucionit por në nivele të pakta. Vitet e fundit fondi i bibliotekës është pasuruar sipas evidencave buxhetore. Nuk u dha informacion specifik mbi pasurimin e fondit të bibliotekës për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 2.8 Fondi i librit</i> <i>Evidencë 4.11.1 Blerjet e fundit të bibliotekës</i> <i>Vizita në terren</i></p>

akademik.				
Konkluzione	<i>Institucioni ka në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve literature fizike dhe digjitale. Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve 2 biblioteka, ajo e Institucionit si dhe bibliotekën pranë Njesisë Kryesore. Pjesë e literaturës fizike gjendet në librarinë e Fakultetit si dhe atë qendrore të Institucionit ndërsa aksesit në library on-line është i mundur sidomos përmes ulibrary.al dhe JSTORE. Literatur fizike nuk ishte e pranishme në department ndërsa literatura e përdorur në syllabus ishte në disa raste e vjetër. Bibliotekat ishin në dispozicion të studentëve gjatë procesit mësimor si dhe përtej atij. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Një sistem i menaxhimit (EMS) është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Menaxhimi i këtij sistemi zhvillohet në bazë të rregullores së miratuar nga Senati Akademik. Ky sistem përmban informacion mbi programin e studimeve, arritjet akademike, pedagogët e ndryshëm të moduleve, planin mësimor, tarifat e shkollimit etj. Aksesit është në varësi të nivelit. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, arritjet akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Sekretaria mësimor ka në formë shkresore a) regjistrin themelatrë të studentëve, b) regjistrin me të dhënat akademike si dhe c) regjistrin e lëshimit të diplomave. Paralelisht, informacion i studentëve gjendet dhe pranë sekretarisë mësimore për secilin student. <i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e	Drejtoria e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e informacionit mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Ajo informon sektorin e IT-së mbi të gjitha nevojat/ndryshimet dhe ai realizon përditësimin e nevojshëm. Drejtoria e burimeve njerëzore krijon, shikon, përditëson dhe gjeneron të dhëna lidhur me personelin akademik, ndihmësakademik, administrative, strukturën organizative, si dhe gjeneron statistika bazuar në informacionin që gjendet në EMS.

programit.	<p><i>Evidencë 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL</i></p> <p><i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i></p> <p><i>Takim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>EMS siguron akses të dedikuar për personelin akademik dhe studentët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik në mënyrë konfidenciale. Informacionet personale për stafin akademik administrohen në mënyrë konfidenciale nga strukturat e UNIEL. Drejtuesi i Departamentin ka akses të veçantë. Ai administron aksesin për pedagogët e Departamentit, administron planet mësimore me fillimin e semestrit, monitoron personelin akademik si dhe gjeneron nga sistemi të dhëna mbi Departamentin që drejton. Pedagogët kanë akses në sistem për të gjeneruar procesverbalin, për të hedhur arritjet akademike të studentëve etj.</p> <p><i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në dokumentacionin e dorëzuar theksohet që sistemi jep mundësinë për komunikim interaktiv apo/edhe për shkëmbimin e informacionit midis pedagogëve e studentëve. Sipas vizitës në terren, ky sistem menaxhimi nuk përdoret për komunikim interaktiv të pedagogëve me studentët apo për shpërndarjen e informacionit.</p> <p><i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i></p> <p><i>Takim me stafin akademik</i></p> <p><i>Takim me studentët</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi EMS garanton monitorim në kohë reale të aktiviteti akademik e administrative si dhe jep mundësinë për raportime individuale. Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Drejtuesi i Njësisë Bazë kanë mundësi të monitorojnë të dhëna që lidhen me njësinë përkatëse që ata drejtojnë. Dekani si dhe drejtuesi i departamentit monitorojnë në kohë reale mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i></p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i></p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i></p> <p><i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacion mbi programet e studimit, personelin akademik, CV-të e tyre, organizimin e aktiviteteve të ndryshme etj. publikohen në faqen zyrtare të UNIEL. Ky informacion është i disponueshëm vetëm në gjuhën shqipe.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Një sistem i menaxhimit (EMS) është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Drejtoria e burimeve njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e informacionit mbi personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Sipas vizitës në terren, ky sistem menaxhimi nuk përdoret</i></p>

	për komunikim interaktiv të pedagogëve me studentët apo për shpërndarjen e informacionit. Informacioni i publikuar në faqen e internetit është vetëm në gjuhën shqipe. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një raport financiar mbi koston e programeve të studimeve. Bazuar në koeficientet e rekomanduar nga MASR për mënyren e llogaritjes së koston; pagën mesatare të punonjësve akademike me tituj/gradë, pagën mesatare të punonjësve ndihmës mesimor; 11 % e shpenzimeve operative dhe 23% e investimeve në buxhetin e parashikuar të vitit 2021, është llogaritur kosto e përgjithshme e studimeve për një student Master profesional në FSHMT. Për vitin akademik 2021 -2022 kosto e përgjithshme për Master profesional parashikohet në vlerën 543,773 leke. Nuk u raportua informacion për mbarëvajtjen financiare të programit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale për të paktën një cikël të plotë studimi.</p> <p><i>Evidencë 4.17 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, grante e fituara, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktivitete trainuese. Plani financiar zhvillohet në nivel institucioni dhe nuk është i disponueshëm plan i financimit të njësisë bazë e cila ofron programin e studimit Master Profesional në Infermieri Kirurgjikale.</p> <p><i>Evidencë 2.3 Miratimi i Buxhetit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga struktura të brendshme e të jashtme. Në strukturën e vet, UNIEL ka ngritur “Auditin e Brendshëm” në varësi të Bordit të Administrimit. Paralelisht, Institucioni auditohet në mënyrë periodike nga auditi i MAS dhe kontrolli i lartë i shtetit. Auditin vlerëson aktivitetin financiar të</p>

	<p>institucionit. Nuk u depozitua nga UNIEL raport auditimi i brendshëm.</p> <p><i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL dhe FSHMT</i> <i>Evidencë 4.14 Raporti i Auditit KLSH 2022</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Njësia Bazë nuk zhvillon raportim financiar.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit dhe grantin që mer nga MAS. Në fund të çdo viti kalendarik institucioni harton raportin vjetor ku përfshihet dhe raportimi financiar. Nuk u depozitua informacion mbi ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve ndërsa gjatë takimeve u theksua mungesa e pjesmarrjes së Departamentit në hartimin e buxhetit në bazë të nevojave të Njesisë.</p> <p><i>Evidencë 2.3 Miratimi i Buxhetit</i> <i>Evidencë 1.12 Analiza vjetore institucionale</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka hartuar një raport financiar mbi koston e programeve të studimeve. Për vitin akademik 2021 -2022 kosto e përgjithshme për Master profesional parashikohet në vlerën 543,773 leke. Nuk u raportua informacion për mbarëvajtjen financiare të programit Master Proesional në Infermieri Kirurgjikale për të paktën një cikël të plotë studimi. Plani financiar zhvillohet në nivel institucioni dhe nuk është i disponueshëm plan i financimit të njësisë bazë e cila ofron programin e studimit MPIK. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Univeriteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” ka hartuar Statutin, Rregulloren e Institucionit, Rregulloren e FSHMT, rregulloren e programit të studimeve si dhe procedura dhe zbaton politika të ndryshme të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Në këto dokumenta të miratuara përcaktohen qartë procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Dokumentacioni i miratuar dhe politikat e hartuara janë në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e FSHMT</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Në bazë të legjislacionit në fuqi, FSHMT harton, miraton dhe publikon kriteret për pranimin në programin e studimeve Master Proesional në “Infermieri Kirurgjikale”. Kriteret e pranimit si dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik dhe i përcillen MAS dhe QSHA.</p> <p><i>Evidencë 1.8.1 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për përparim përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve etj. Tek rregullorja e Departamentit, Kreu IV, V dhe kreu VI (nenet 23-46) jepen informacione të detajuara mbi organizimin e studimeve, kontrollin e dijeve dhe vlerësimin, transferimin e studimeve, njohjen dhe njësimin e periudhave të studimit ndërsa tek rregullorja e programit mësimor jepet informacion mbi procedurat e pranimit (neni 21). Informacion I detajuar përfshihet po ashtu edhe tek statute i</p>

	<p>institucionit, “KREU VII: Programet e studimit dhe organizimi i tyre” (nenet 46-61). Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen ëeb.</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni ka përcaktuar në rregulloret e departamentit dhe të programit të studimit kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve. Pranimi në programet e studimit të ciklit të ciklin e dytë është i mundur për cdo student që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve në fushat që lidhen me programin e studimeve. Në RVB dhe në dokumentacionin shoqërues ka evidencë të procedurës ligjore të ndjekur çdo vit për hartimin dhe publikimin e kriterëve për pranimin në ciklin e dytë të studimeve. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programin e studimit MPIK publikohen në faqen zyrtare të Institucionit. Nota mesatare e diplomës në programin e parë (Bachelor) të studimit është vendosur si kriter pranimi ndërsa si si kriter përzgjedhes është mesatarja e ponderuar e aplikantëve në programin e studimit Bachelor. Politikat dhe procedurat e pranimi në këtë program studimi detajohen në rregulloren e programit të studimeve (nenet 20-22).</p> <p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 1.8.1 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimi për programin e studimit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Për pranimin në këtë program studimi nuk janë hartuar kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Siaps diskutimeve me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe të Njësisë Bazë, respektohen aftësitë ndryshe të personave që aplikojnë.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 1.8.1 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimi për programin e studimit</i> <i>Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore/Bazë</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për këtë program studimi nuk janë hartuar kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Sipas Nenit 20 të rregullores së programit të studimeve, në programin Master Proesional në “Infermieri Kirurgjikale”, pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe nga vende të tjera pasi kandidatët kryejnë procedurën e fituara jashtë vendit pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin. Siaps diskutimeve me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe të Njësisë Bazë, kandidatë nga trojet janë regjistruar në këtë program studimi në të kaluarën. Në këtë moment nuk ka student të regjistruar në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i></p>

Mehdi

Dustaj

	<i>Evidencë 1.8.1 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit</i> <i>Takimi me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në bazë të legjislacionit në fuqi, Institucioni miraton politika ndihmëse dhe bursa për studentët. Përjashtimi nga tarifa apo bursat miratohen nga Bordi i Administrimit. <i>Evidencë 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik UNIEL</i>			
Konkluzione	<i>Në dokumentacionin e hartuar nga UNIEL egzistojnë evidenca të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje duke garantuar baraza për të gjithë studentët. Kriteret e pranimit si dhe kuotat miratohen nga Senati Akademik dhe i përcillen MAS dhe QSHA ndërsa informacion i detajuar mbi procedurat e pranimit është i disponueshëm për studentët dhe publikun. Nuk ka kriterë specifike për grupet me aftësi ndryshe ndërsa aksesit për studentë të huaj është e mundshme (veçanërisht për rata nga trojet). Bursa dhe përjashtime nga tarifa janë në dispozicion të studentëve në bazë të kushteve ligjore. Sipas mendimit të GVJ ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Tek rregullorja e Departamentit, (neni 28) jepet informacion mbi kushtet e detyrueshme në kalimin në vitin pasardhës. Në syllabuset e programit gjendet po ashtu informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik. <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët kanë akses në informacion në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme (neni 42 dhe 43) <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Pedagogët në fillim të vitit akademik informojnë studentët me kriteret e vlerësimit të dijeve. Tek rregullorja e Departamentit, (nenet 31-33) dhe në rregulloren e programit të studimeve (nenet 15-16) jepet informacion mbi kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve. Informacion më i detajuar për secilin modul jepet tek syllabuset e programit të studimeve. Për shkak të mungesës së studentëve në këtë program studimi, nuk u bë e mundur verifikimi nga studentët i këtij kriteri.

	<p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Takimi me stafin akademik</i> <i>Takimi me studentët</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Pedagogët informojnë studentët në lidhje me punimin e diplomës ndërsa institucioni ka hartuar një manual specific për punimin e diplomës. Në këtë program studimi, studentët nuk hartojnë tem diplome sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesin e Departamentit.</p> <p><i>Evidencë 3.5</i> <i>Takimi me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Përpara fillimit akademik institucioni zhvillon takime me qëllim informimin e të interesuarve në këtë program studimi. Organizimi i ditëve të hapura është një procedurë e zakonshme që zhvillon për të tërhequr student të rinj. Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletë palosjeve dhe organizimit të ditëve informuese.</p> <p>Duhet të intesifikohen përpjekjet për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi pasi dy vitet e fundit nuk ka regjistrime.</p> <p><i>Evidencë 5.3 Kalendar i ditëve të hapura</i> <i>Evidencë 5.4 Publikimi i sportit motivues</i> <i>Evidencë 5.5 Fletpalosjet promovuese institucionale</i> <i>Takimi me stafin akademik</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Dokumentat e hartuara nga Institucioni u japin mundësi studentëve të marrin informacionin e nevojshëm mbi përparimin akademik, kreditet e nevojshme, kalimin nga viti në vit, njohen e studimeve të mëparshme, procedurat e vlerësimit të dijeve si dhe atyre të përpunimit të diplomës. Po ashtu organizon takime të rregullta për informimin e kandidatëve të mundshëm. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar mbi programin e studimeve, organizimin, kohëzgjatjen etj. Në fillim të vitit akademik ata informohen nga Koordinatorin e Programit të studimit. Informacion i detajuar po ashtu gjendet tek rregullorja e programit të studimit (neni 23-24) si dhe tek rregullorja e departamentit (neni 11). Për shkak të mungesës së studentëve në këtë program studimi, nuk u bë e mundur verifikimi nga studentët i këtij kriteri.</p>

M. Schifano

Rusby

	<p><i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 2.11 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit</i> <i>Takimi me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dhe shpërndarjen e tyre në semestral, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve sipas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të mësimit (leksion, seminar, praktikë).</p> <p><i>Evidencë 2.11 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e lëndëve</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në strukturën e vet Zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni e cila organizon aktivitete të ndryshme për orientimin e studentëve në tregun e punës. Për këtë program studimi, aktivitetet më të shumta për punësim të studentëve organizohen nga kompani të fushës dhe jo nga vet institucioni.</p> <p><i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i> <i>Takimi me studentët</i> <i>Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në fillim të vitit akademik koordinatori i programit të studimeve informon studentët mbi organizimin e studimeve, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme. Secili pedagog informon studentët mbi modalitetet e secilës lëndë që ata zhvillojnë ndërsa sekretaria mësimore pajis me email si dhe kodet personale për secilin për akses në systemin EMS. Pranë sekretarisë marrin shpesh herë po ashtu edhe informacion mbi sallat e ndryshme dhe infrastrukturën e Njësisë Kryesore. Për shkak të mungesës së studentëve në këtë program studimi, nuk u bë e mundur verifikimi nga studentët i këtij kriteri.</p> <p><i>Evidencë 2.11 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit</i> <i>Takimi me studentët</i> <i>Takimi në sekretarinë mësimore</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm</p>	<p>UNIEL ka ndërtuar një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili funksionon në distancë. Studentët dhe pedagogët kanë mundësi ta aksesojnë atë nga vendi ku ata ndodhen. Studenti dhe pedagogu disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhënat e tij në cdo moment.</p>

M. Medina

D. S. S.



nga studentët edhe në distancë.							
Konkluzione	<i>Institucioni u vë në dispozicion studentëve informacion për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve. Pralësisht, nga koordinatori i programit të studimeve ata marrin informacion të detajuar mbi studimet dhe detyrimet e tyre. Pavarësisht përpjekjeve, nuk ka një procedurë të mirëorganizuar për përndësitet e punësimit të studentëve. Për shkak të mungesës së studentëve në këtë program studimi, disa nga kriteret nuk ishte e mundur të verifikoheshin. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet kryesisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni ka të dhëna statistikore mbi numërin e studentëve si dhe atyre të diplomuar në këtë program studimi. Ky informacion është i disponueshëm nga sekretaria mësimore. Përdorimi i EMS ndihmon në përgatitjen e këtyra statistikave. Të dhënat janë të mundshme përmes 1) regjistrimit themeltar të studentëve, regjistrimit të lëshimit të diplomave dhe regjistrimit me arritjet akademike (regjistri i notave). Krijimi i një sektori specifik (ose një person përgjegjës) për të mbajtur dhe për të përditësuar të dhënat statistikore do ishte e nevojshme. <i>Takimi në sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni përmes sistemit EMS ka të mundshme hartimin e statistikave vjetore për numërin e studentëve të regjistruar në programin e studimit deri në momentin që ata diplomohen. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit, të regjistrimit në programet e dyta dhe të çregjistrimit. <i>Evidencë 3.7 Modalitetet e organizimit dhe të funksionimit të sekretarisë mësimore në FSHMT</i> <i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Përdorimi i sistemit EMS mundëson menxhimin e të dhënave statistikore. Secili nga përdoruesit ka nivele të ndryshme aksesit në bazë të funksionit të vet si dhe duke ruajtur konfidencialitetin. <i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i>

<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Kontrolli periodik është i mundur nga instancat përgjegjëse në Institucion. Në Statutin e UNIEL Kreu III përfshihen funksionet e autoriteteve drejtuese ku përmenden edhe detyrat kontrolluese të tyre. Dekani i FSHMT ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit (neni 9, evidence 1.8). Kompetencat mbi kontrollin periodik përfshihen të detajuar në rregulloren e UNIEL (neni 24, nenet 25-33). Institucioni po ashtu ka hartuar një dokument specifik mbi krijimin, ruajtjen, shërbimin dhe dorëzimin e dokumentave në UNIEL.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidencë 3.6 Rregullore për krijimin ruajtjen, shërbimin dorëzimin e dokumentacionit në UNIEL</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raportet përpilohen në formën e analizës vjetore dhe i bashkëlidhen raportit vjetor të institucionit. Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimi dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga komunikimi me Institucionet e tjera vendore. Në takimin me personelin akademik dhe drejtuesit e FSHMT, GVJ kërkoi informacion mbi licensimin dhe punësimin e studentëve. Nga presidentia e Urdhërit të Infermierit e cila ishte prezente në takim u raportua se studentët e UNIEL janë të dytët më të suksesshëm në rang Republike në provimin e licensës. Pavarësisht këtyre, informacion më i detajuar dhe i përditësuar është i nevojshëm.</p> <p><i>Evidencë 1.12.1 Analiza vjetore e DSTM 2020-2021</i> <i>Evidencë 5.7 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021</i> <i>Takimi me Stafin akademik</i> <i>Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka të dhëna statistikore mbi numërin e studentëve si dhe atyre të diplomuar në këtë program studimi. Përdorimi i sistemit të brendshëm asiston në këtë objektiv. Kontrolli periodik është i mundur nga instancat përgjegjëse në Institucion ndërsa në raportin vjetor përfshihen informacione mbi cilësinë e studentëve. Nevoja për përmirësim me informacion rregullisht të përditësuar dhe me ndërtimin e politikave dhe strategjive afatgjata është i nevojshëm. Pavarësisht problematikave që egzistojnë, sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi V.5
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregulatore të vetë institucionit.</p>	<p>Bazuar në ligjin 80/2015, aktet nënligjore si dhe dokumentacionin e miratuar nga UNIEL, studentët përfshihen në organet vendimmarrëse e këshilluese të Institucionit. Studentët janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë një rregullore të këshillit studentor. Nuk u paraqit dokumentacion mbi aktivitet të këshillit studentor. Gjatë takimit me studentët ata deklaruan se kontaktojnë zakonisht me anëtarët e organeve të tyre për problematika të ndryshme.</p> <p><i>Evidencë 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik</i> <i>Evidencë 2.2 Rregullore e Këshillit studentor</i> <i>Evidencë 5. 8 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor</i> <i>Evidencë 5.9 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional</i> <i>Evidencë 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL</i> <i>Evidencë 5.11 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet</i> <i>Evidencë 5.12 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programet FSHMT</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët kanë një rregullore të këshillit studentor. Nuk u paraqit dokumentacion mbi aktivitet të këshillit studentor. Gjatë takimit me studentët ata deklaruan se kontaktojnë zakonisht me anëtarët e organeve të tyre për problematika të ndryshme. Evidentimi i përfshirjes së studentëve në vendimmarrje duhet të jetë më i qartë. Mungesa e studentëve në këtë program studimi sjell po ashtu problematika në verifikim të përfshirjes së tyre.</p> <p><i>Evidencë 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik</i> <i>Evidencë 2.2 Rregullore e Këshillit studentor</i> <i>Evidencë 5. 8 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor</i> <i>Evidencë 5.9 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional</i> <i>Evidencë 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme institucionale në UNIEL</i> <i>Evidencë 5.11 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet</i> <i>Evidencë 5.12 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programet FSHMT</i> <i>Takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe</p>	<p>Institucioni raporton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit mësimor. Studentët përbëjnë një nga grupet kryesore të interesit. Studentët plotësojnë pyetësorin e hartuar nga NJSBC në mënyrë të rregullt dhe sugjerojnë përmirësime. Sipas takimit me studentët, ata nuk ishin përfshirë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Mungesa e studentëve në</p>

<p>reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>këtë program studimi sjell po ashtu problematika në verifikim të përfshirjes së tyre.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021 -2022</i> <i>Evidencë 6.3 Urdhërat për zhvillimin e pyetësorëve institucional 2021-2022</i> <i>Takimi me studentët</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e FSHMT (neni 40) si dhe rregulloren e Departamentit (neni 38) studentët kanë të drejtë të ankohen në rast se janë shkelur rregullat procedurale të zhvillimit të provimit. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, duke iu drejtuar Dekanit të fakultetit. Dekani vlerëson ankesën dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Në rast se, nga shqyrtimi i ankimit, vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e Rregullores, me propozimin e drejtuesit të DSTM, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit dhe për ridhënien e provimit ose kolokiumit brenda ditës ose te nesërmen. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të konsideruar si të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së shpalljes së rezultateve, duke iu drejtuar drejtuesit të DSTM me një ankesë me shkrim. Drejtuesi i DSTM vlerëson nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe ngarkon komisionin me aktin përkatës, që të rivlerësojë edhe njëherë provimin dhe të bëjë ballafaqim me studentin. Ky vendim është i formës së prerë dhe depozitohet në njesinë bazë dhe sekretarinë mesimore. Komisioni merr vendim për rivlerësimin. Rezultati i rivlerësimit pasqyrohet në sistem. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe Bazë, stafin akademik dhe studentët, u raportua se nuk ka patur raste të ankimit që të përdoret kjo procedurë.</p> <p><i>Evidencë 1.7 Rregullore e Fakultetit</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e Departamentit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët janë anëtarë të Senatit Akademik, përzgjedhin përfaqësuesin e tyre në Bordin e Administrimit si dhe në komisionet e ndryshme. Studentët janë po ashtu edhe pjesë në hartimin e raporteve të vlerësimit të brendshëm. Studentët po ashtu kanë një rregullore të këshillit studentor. Nuk u paraqit dokumentacion mbi aktivitetet të këshillit studentor. Institucioni raporton se studentët përfshihen në përmirësimin e programit të studimit ndërsa studentët raportuan se nuk ishin përfshirë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Studentët kanë mundësi të ankimojnë vlerësimin nga pedagogu. Sipas mendimit të GVJ ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



Standardi V.6
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ofron informacion studentëve për çështje të ndryshme që ata mund të kenë. Studentët mund ti drejtohen për info tek “Shtëpia e pritjes” ndërsa në faqen zyrtare të Institucionit ata informohen mbi çështje të ndryshme si dhe aktivitete që zhvillohen. Studentët po ashtu kanë mundësi të marrin informacion pranë sekretarive mësimore si dhe pranë Drejtuesit të Departamentit. Në takimin me studentët ata raportuan që marrin informacionin që nevojitet në përgjithësi. Mungesa e instrumentave matës është një pikë e dobët dhe siç u raportua nga NJSBC, po punohet me qëllim krijimin e një pyetësoi i cili do të vlerësoj stafin ndihmës akademik dhe administrative.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL</i> <i>Faqe zyrtare e Institucionit</i> <i>Takimi me studentët</i> <i>Takimi me NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Një sistem i menaxhimit (EMS) është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Menaxhimi i këtij sistemi zhvillohet në bazë të rregullores së miratuar nga Senati Akademik. Ky sistem përmban informacion mbi programin e studimeve, arritjet e tyra akademike, pedagogët e ndryshëm të moduleve, planin mësimor, tarifat e shkollimit etj. Aksesit është në varësi të nivelit. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, arritjet akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidenciale mer informacion për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentoj apo provimet që do të jap gjatë vitit akademik. Sekretaria mësimor ka në formë shkresore a) regjistrin themelatrë të studentëve, b) regjistrin me të dhënat akademike si dhe c) regjistrin e lëshimit të diplomave. Paralelisht, informacion i studentëve gjendet dhe pranë sekretarisë mësimore për secilin student.</p> <p><i>Evidencë 4.12 Rregullorja EMS</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka në përbërjen e vet Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni. Sektori i këshillimit të karrierës dhe alumni zhvillon aktivitete të ndryshme për maturantët si dhe organizon aktivitete të ndryshme trajnuese për studentët. Sektori po ashtu zhvillon gjurmimin e të diplomuarve përmes shkresave që u përcjell institucioneve të ndryshme. Sektori përmendi zhvillimin e aktiviteteve mbi orientimin e studentëve sit ë hartojnë një letër motivimi, CV-në etj. Në takimin me studentët, ata raportuan që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të këshillimit të karrierës.</p> <p><i>Evidencë 1.10 Lista e trajnimit të studentëve</i> <i>Evidencë 5.3 Kalendari i ditëve të hapura</i> <i>Evidencë 5.7 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve</i> <i>Takim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të</i></p>

	<i>Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Sektori i këshillimit të karrierës dhe alumni zhvillon aktivitete për gjurmimin e studentëve. Gjurmimin e bëjnë duke përdorur një formular specifik në faqen zyrtare të Institucionit, nëpërmjet emai-eve dhe shkresave që iu nisen Institucioneve në qarkun e Elbasanit <i>Evidencë 5.7 Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve Takim me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ofron informacion studentëve për çështje të ndryshme që ata mund të kenë. Një sistem i menaxhimit (EMS) është i ndërtuar nga institucioni i cili përmban informacion që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në përfundim të studimeve. Sektori i këshillimit të karrierës dhe alumni zhvillon aktivitete të ndryshme për maturantët si dhe organizon aktivitete të ndryshme trajnuese për studentët. Mungesa e instrumentave matës është një pikë e dobët dhe siç u raportua nga NJSBC, po punohet me qëllim krijimin e një pyetësoi i cili do të vlerësoj stafin ndihmës akademik dhe administrative. Në takimin me studentët, ata raportuan që nuk kanë marrë pjesë në aktivitete të këshillimit të karrierës. Mungesa e studentëve në këtë program studimi është një problematik e madhe për të cilën Institucioni duhet të marri masa të menjëhershme. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VL1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni raporton se pedagogët gjatë mësimdhënies përdorin metoda të ndryshme inovative. Në vizitën e zhvilluar në ambientet e fakultetit, laboratorit i anatomisë i jepte mundësinë studentëve zhvillimin e një leksioni modern falë pajisjeve. Paralelisht, Institucioni nxit mobilitetin e pedagogëve jashtë vendit përmes programit ERASMUS+ me qëllim mësimdhënien dhe trajnimin në metoda inovative. Gjatë takimit me pedagogët ata raportuan përdorimin e metodave të ndryshme përfshirë këtu diskutimet, role-play, çorking groups, përdorimin e metodave interaktive etj. në leksionet që ata zhvillojnë. Pavarësisht përpjekjeve, ka një mungesë të një udhëzuesi specifik nga Institucioni për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit të FSHMT Takimi me stafin akademik Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Implementimi i pyetësorëve u jep studentëve mundësinë të vlerësojnë pedagogët në mësimdhënie me qëllim vlerësimin e përdorimit të metodologjive inovative. Sipas takimeve të zhvilluara, Drejtuesi i Njësisë Kryesore dhe Bazë vleron rregullisht performancën e pedagogëve por nuk ka mekanizma dhe raporte specifike për këtë çështje. Propozohet që në vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të përfshihen dhe metodologji të tjera përfshirë këtu vetëvlerësim i pedagogut, fokus-grupe si dhe pilotim të metodave të ndryshme të reja para se të implementohen në të gjithë Institucionin.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022 Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësinë Bazë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Institucioni implementon rregullisht pyetësorin për vlerësimin e stafit akademik nga studentët. Në bazë të rezultateve, implementon masa të ndryshme të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Studentët përmes përfaqësuesve të tyre kanë mundësinë të raportojnë problematika të ndryshme. GVJ sugjeron që institucioni në bazë të rezultateve të pyetësorit NJSBC në bashkëpunim me strukturat e tjera të hartoj një plan masash të matshëm dhe ta implementoj atë. Paralelisht, propozon dhe metoda alternative të vlerësimit nga studentët përfshirë këtu edhe fokus grupe.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022 Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit bëhen publike duke respektuar të dhënat konfidenciale.</p>



cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i>		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Në takimet e zhvilluara u raportua se pedagogët njihen me rezultatet e vlerësimit të pyetësorit. Paralelisht, në mbledhjet që zhvillohen (department, dekanat) diskutohen praktikat e ndryshme në bazë të raportit. Nuk u raportuan aktivitete apo mekanizma specifike për vlerësimin e rezultateve të marra. Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësinë Bazë Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni		
Konkluzione	<i>Institucioni raporton se pedagogët gjatë mësimdhënies përdorin metoda të ndryshme inovative. Implementimi i pyetësorëve u jep studentëve mundësinë të vlerësojnë pedagogët në mësimdhënie me qëllim vlerësimin e përdorimit të metodologjive inovative. GVJ sugjeron që institucioni në bazë të rezultateve të pyetësorit të hartoj një plan masash të matshëm dhe ta implementoj atë. Paralelisht, propozon dhe metoda alternative të vlerësimit nga studentët përfshirë këtu edhe fokus grupe. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet kryesisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standarti VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UNIEL në strukturën e vet ka Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni pjesë e së cilës është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. NJSBC ka në përbërjen e saj 1 përgjegjës dhe 2 specialistë. veprimtaria e përgjegjësit është e fokusuar në zbatimin e drejtëpërdrejtë të procedurave dhe standardeve të përcaktuara me ligj/aktet nënligjore ose të hartuara nga institucioni i arsimit të lartë ndërsa specialistët kryejnë punën brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave të caktuara nga përgjegjësi. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve organizon pyetësorin institucional dhe pyetësorin vlerësues nga studentët për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për standartet e Cilësisë. Ky komision përbëhet nga shtatë anëtarë prej të cilëve 1 përfaqësues nga çdo Njësi Kryesore, Zv. Rektori si dhe një përfaqësues i studentëve. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton, në bashkëpunim me Komisionin e Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e

	<p>Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies. Paralelisht,</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti (neni 71)</i> <i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i> <i>Evidencë 5.10 Urdhëri për komisionet e përherëshme institucionale UNIEL</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UNIEL ka në strukturën e vet NJSBC e cila është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë. Paralelisht, ka ngritur Komisionin e Përherëshëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë harton, në bashkëpunim me Komisionin e Përherëshëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit, raportin mbi rezultatet dhe gjetjet e pyetësorit institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies. Në Statutin e UNIEL sigurimi i cilësisë është një pikë kryesore (neni 71). Funkcionet dhe kompetencat e Njësisë janë të detajuara në rregulloren e Institucionit (neni 24) ndërsa kompetencat dhe funksionet e Komisionit detajohen në nenin 36. Njësia ka hartuar një rregullore specifike të cilën e zbaton. Bashkëpunëtorët e jashtëm janë të pranishëm përmes Bordit Këshillimor të Biznesit i ngritur në nivel Institucioni. Po ashtu, pedagogët me kohë të pjesshme të cilët janë personel infermieror bashkëpunojnë për përmirësimin e cilësisë sipas nevojave dhe rasteve.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UNIEL</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e UNIEL</i> <i>Evidencë 4.6 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillor të6 Biznesit 2021 - 2022</i> <i>Evidencë 5.10 Urdhëri për komisionet e përherëshme institucionale UNIEL</i> <i>Evidencë 6.8 Rregullore e NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë. Anëtarët e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ta që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, ekspertiza përqëndrohet në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit. NJSBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. UNIEL ndjek periodikisht procesin e vlerësimit të jashtë. Institucioni është i akredituar nga ASCAL (për një periudhë 6-të vjeçare) si dhe programet e studimit janë akredituar ose janë në proces akreditimi.</p> <p><i>Evidencë 1.6 Çertifikatë akreditimi Institucional</i> <i>Evidencë 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në</p>	<p>UNIEL përdor pyetësorin që plotësojnë studentët për të vlerësuar procesin e mësimdhënies. Në takimin me Drejtorinë e Kurrikulave dhe</p>

<p>mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni u përmend se UNIEL përdor një formular për vlerësimin e mësimdhënies së pedagogëve dhe kërkimin shkencor. Rezultatet e arritura raportohen në raportin vjetor. GVJ nuk arriti të identifikonte indikatorë të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim dhe për këtë arsye sugjeron që Institucioni të hartojë dhe të implementojë. Në bazë të rezultateve të hartojë plan masash të detajuar.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i> <i>Evidencë 6.3 Urdhër për Zhvillimin e Pyetësorëve Institucional Takimi me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>UNIEL në strukturën e vet ka Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni pjesë e së cilës është edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Institucioni ka ngritur Komisionin e Përhershëm për standartet e Cilësisë. UNIEL ndjek periodikisht procesin e vlerësimit të jashtë ndërsa nuk u identifikuan indikatorë të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. Sipas mendimit të GVJ, standardi përmbushet kryesisht.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>DSTM harton raportin vjetor i cili i bashkëlidhet raportit të Njesisë Kryesore si dhe raportit të UNIEL. Raporti përfshinë analizën e punës mësimore dhe shkencore të departamentit, ngarkesën mësimore, arritjet kërkimore të pedagogëve, cilësinë e materialeve mësimore si dhe evidentohen propozime për vitin akademik të ardhshëm. Raporti i përcillet Dekanit të Fakultetit. Pavarësisht evidentimit të problematikave, nuk paraqitet një plan masash konkret.</p> <p><i>Evidencë 1.12 Analiza vjetore</i> <i>Evidencë 1.12.1 Analiza vjetore e Departamentit 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit</p>	<p>Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit.</p>

<p>duhet të përfshijnë rezultatet e prishme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në mbledhjet e departamentit analizohen të dhënat e vlerësimit dhe diskutohet plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Në raportin vjetor të departamentit përfshihet evidentimi i disa çështjeve për vitin akademik pasardhës por nuk paraqitet plan masash.</p> <p><i>Evidencë 1.12.1 Analiza vjetore e Departamentit 2020-2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>UNIEL organizon rregullisht pyetësin e studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit. Raporti përpunohet dhe nxirren rezultatet/konkluzionet të cilat publikohen. Në bazë të rezultateve Institucioni implementon procedura për përmirësimin e situatës që raportohet në raportin vjetor të Institucionit. Në rregulloren e FSHMT, departamentit, programit të studimeve dhe syllabuset e pedagogëve parashikohen dhe metoda alternative të vlerësimit përveç provimit për vlerësim. Në diskutimin e zhvilluar me Presidenten e Urdhërit të Infermierit, u raportua se në provimin e licencës studentët e UNIEL kanë arritje shumë të larta. Përfshirja e më shumë instrumentave për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies është e nevojshme.</p> <p><i>Evidencë 1.12 Analiza vjetore</i> <i>Evidencë 1.12.1 Analiza vjetore e Departamentit 2020-2021</i> <i>Evidencë 1.7.1 Rregullore e departamentit</i> <i>Evidencë 1.8 Rregullore e programit të studimeve</i> <i>Evidencë 2.12 Syllabuset e programit mësimor</i> <i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i> <i>Evidencë 6.3 Urdhër për Zhvillimin e Pyetësorëve Institucional</i> <i>Takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>UNIEL organizon rregullisht pyetësin e studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit. Nuk u raportuan metoda të tjera në kuadër të vlerësimit të programit të studimit. Alumni merr pjesë përmes Bordit Këshillimor të Biznesit ndërsa pedagogët me kohë të pjesshme të përfshirë në këtë program studimi janë pjesë e alumni dhe rregullisht propozojnë përmirësime dhe rekomandime. Gjatë takimeve u raportua se Institucioni është duke hartuar instrumenta të reja për të vlersuar shërbimet ndihmësakademike dhe administrative nga ana e studentëve. Organizimi i një vlerëimi 360° është një nga sugjerimet kryesore të GVJ-së. Po ashtu rekomandohet që sugjerimet e stafit me kohë të pjesshme, alumni si dhe bashkëpunorëve të jashtëm të jenë të dokumentuara.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>DSTM harton raportin vjetor i cili i bashkëlidhet raportit të Njësisë Kryesore si dhe raportit të UNIEL. Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit. UNIEL organizon rregullisht</i></p>

	pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e mësimdhënies dhe programit të studimit. Përfshirja e më shumë instrumentave për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies është e nevojshme si dhe i një vlerëimi 360°. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet kryesisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNIEL ka ngritur Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë. Ky komision përbëhet nga shtatë anëtarë prej të cilëve 1 përfaqësues nga çdo Njësi Kryesore (përfshirë këtu FSHMT), Zv. Rektori si dhe një përfaqësues i studentëve. Paralelisht, FSHMT ka ngritur Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë së Njësisë Kryesore dhe programeve të studimit në nivel Njësie Kryesore. Ky komision është i përbërë nga 5 anëtarë ku 4 janë staf akademik dhe 1 është student. Me qëllim përfshirjen e aktorëve të jashtëm Institucioni ka ngritur Bordin Këshillimor të Biznesit. Po ashtu, pedagogët me kohë të pjeshme (pjesë e alumni e FSHMT në rastet më të shumta) përfshihen në sigurimin e cilësisë përmes rekomandimeve/sugjerimeve që ofrojnë. GVJ propozon dokumentimin e rekomandimeve të faktorëve të jashtëm.</p> <p><i>Evidencë 5.10 Urdhëri për komisionet e përherëshme institucionale UNIEL</i></p> <p><i>Evidencë 5.11 Urdhëri për komisionet e përherëshme në nivel Fakulteti Takimi me stafin akademik</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Të gjithë aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë kanë funksione dhe detyrime të përcaktuara qartë në rregullat e brendshme të Institucionit. Funksionet dhe kompetencat e NJSBC pasqyrohen në nenin 18 të Rregullores së Institucionit si dhe në rregulloren e NJSBC. Neni 36 i Rregullores së Institucionit përcakton funksionet dhe kompetencat e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë në nivel Institucional ndërsa neni 38 funksionet dhe detyrimet e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë së Njësisë Kryesore dhe programeve të studimit. Detaje mbi funksionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë prezantohen në rregullore e tij. Studentët janë pjesë e këtyre komisioneve dhe kanë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara. Përfshirja e palëve të treta zhvillohet në bazë të mundësive por pa përgjegjësi dhe detyrime konkrete.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e UNIEL</i></p>

	<p><i>Evidencë 6.7 Rregullore për Funkcionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë</i> <i>Evidencë 6.8 Rregullore e NJSBC</i></p>		
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë në nivel Institucioni ka anëtarë nga të gjitha Njësitë Kryesore përfshirë edhe nga FSHMT. Komisioni i Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë së Njësisë Kryesore dhe programeve të studimit ka anëtarë nga DSTM i cili në këtë rast është Dekani dhe Kryetari i këtij komisioni. Në të dyja komisionet janë të përfshirë personeli akademik si dhe studentët si anëtarë. Personeli administrative është i përfshirë përmes NJSBC.</p> <p><i>Evidencë 5.10 Urdhëri për komisionet e përherëshme institucionale UNIEL</i> <i>Evidencë 5.11 Urdhëri për komisionet e përherëshme në nivel Fakulteti</i> <i>Evidencë 6.7 Rregullore për Funkcionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë</i> <i>Tabela 24</i></p>		
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Të gjithë anëtarët e stafit akademik si dhe studentët kanë të drejtë pa përjashtim të kandidojnë dhe të zgjidhen. Kjo shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie të mundëshme. Staf i UNIEL është i detyruar të respektojë kodin e etikës së miratuar nga Institucioni.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e UNIEL</i> <i>Evidencë 6.5 Kodi i etikës UNIEL</i> <i>Evidencë 6.7 Rregullore për Funkcionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjatë diskutimeve me stafin akademik si dhe me NJSBC u raprtua përfshirja e aktorëve të jashtëm për sigurimin e cilësisë. Ngritja e Bordit Këshillimor të Biznesit ndihmon në procesin e përmirësimit të cilësisë. Aktorë të jashtëm në FSHMT janë zakonisht pjesë e alumni dhe që punojnë si staf i spitaleve ose qendrave shëndetësore dhe të përfshirë në praktikat mësimore. GVJ nuk evidentoi aktivitete të tilla të dokumentuara.</p> <p><i>Takimi me stafin akademik</i> <i>Takim me NJSBC</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>UNIEL ka ngritur Komisionin e Përhershëm për garantimin e standarteve të Cilësisë sin ë nivel Institucioni ashtu dhe në nivel Njësie Kryesore. Staf akademik dhe student janë të përfshirë si anëtarë të këtyre komisioneve të cilat kanë detyra dhe funksione të caktuara. GVJ propozon dokumentimin e përfshirjen dhe rekomandimet e aktorëve të jashtëm. <i>Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	



Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të

Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UNIEL publikon raportet e pyetësorëve të studentëve rregullisht në faqen zyrtare të vet. Paralelisht, publikon strategjitë e rregulloret e ndryshme si dhe aktet e brendshme të cilat lidhen me sigurimin e cilësisë. Në këto dokumenta studentët si dhe të gjithë të interesuarit kanë akses. Me qëllim transparencën dhe informimin pa dallim, UNIEL ka miratuar “Programin e Transparencës” ku përmendet se Institucioni i jep publikut, informacion për standardet e cilësisë.</p> <p><i>Evidencë 5.13 Miratimi i Programit të Transparencës</i> https://eëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e pyetësorëve të studentëve bëhen publike nga Institucioni. Po ashtu, informacion lidhur me sigurimin e cilësisë përfshihet në raportin vjetor të UNIEL i cili është publik. I gjithë informacioni që publikohet respekton lirinë dhe etikën profesionale duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale. Kodi i etikës së Institucionit përcakton qartë të dhënat që mund dhe ato që nuk mund të publikohen.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i> <i>Evidencë 6.8 Rregullore e NJSBC</i> <i>Takimi me NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Raporti i analizës së pyetësorëve përfshin disa përfundime dhe rekomandime në bazë të rezultateve. GVJ nuk arriti të evidentonte një plan masash konkret me objektivat specifike, afatet kohore, strukturat e nevojshme etj. GVJ sugjeron hartimin e planit të masave me qëllim vlerësimin afatmesëm dhe afatgjatë të arritjeve.</p> <p><i>Evidencë 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UNIEL përmes strukturave të ngritura monitoron programin e studimit me qëllim përmirësimin e tij. NJSBC, si dhe Komisionet në nivel Institucional dhe nivel Njësie Kryesore vlerësojnë në mënyrë të vazhdueshme këtë proces. Në bazë të kuadrit ligjor, Njësia Bazë ka mundësinë të propozoj riorganizim të programit deri në masën 20%. Ato ndryshime i përcillen Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit (nëse ka efekte financiare) për miratim. Pyetësorët që organizon institucioni është një metodë për monitorimin e vlerësimin e cilësisë. GVJ rekomandon organizimin e aktiviteteve dhe dokumentimin e tyre që lidhen me përmirësimin e cilësisë së programit të studimeve.</p> <p><i>Evidencë 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i> <i>Evidencë 5.10 Urdhëri për komisionet e përherëshme institucionale UNIEL</i> <i>Evidencë 5.11 Urdhëri për komisionet e përherëshme në nivel Fakulteti</i> <i>Evidencë 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për garantimin e standarteve të Cilësisë</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për</p>	<p>Një nga rolet kryesore të NJSBC është informimi rregullisht i pedagogëve dhe studentëve për sigurimin e cilësisë. NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë. Anëtarët e saj vizitojnë rregullisht çdo fakultet dhe çdo departament dhe ftohen nga ta që të ofrojnë ekspertizë në zhvillimin</p>

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>e proceseve përkatëse të sigurimit të cilësisë. Në veçanti, ekspertiza përqëndrohet në zbatimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënit. Gjatë takimit me pedagogët dhe strukturë NJSCB ata raportuan se zhvillojnë rregullisht takime me qëllim informimin e stafit akademik dhe studentëve. GVJ sugjeron dokumentimin e këtyre aktiviteteve, problematikat e dala nga këto takime si dhe masat për kapërcimin e tyre.</p> <p><i>https://www.uniel.edu.al/njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ue Takim me stafin akademik Takim me NJSCB</i></p>			
Konkluzione	<p><i>UNIEL publikon raportet e pyetësorëve të studentëve rregullisht në faqen zyrtare të vet. Paralelisht, publikon strategjitë e rregulloret e ndryshme si dhe aktet e brendshme të cilat lidhen me sigurimin e cilësisë. GVJ sugjeron hartimin e planit të masave me qëllim vlerësimin afatmesëm dhe afatgjatë të arritjeve. Sipas mendimit të GVJ, ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” ofruar nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet nga staf akademik me tituj dhe grada dhe përmbush detyrimet ligjore;
2. Kapacitetet e FSHMT si dhe infrastruktura laboratorike është bashkëkohore, me pajisje moderne në funksion të programit të studimit;
3. Kurrikula e programit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” është hartuar në bazë të kuadrit ligjor kombëtar si dhe ka ngjashmëri të lart me programet e njëjta të huaja;
4. Krijimi dhe zbatimi i një sistemi menaxhimi të brendshëm në UNIEL (programi EMS) u jep mundësi studentëve të kenë akses në kohë reale në programin e studimit, arritjet akademike, stafin akademik etj.;
5. Ngritja e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë së Institucionit dhe programeve të studimit të FSHMT.

Pika të dobta:

1. Mos regjistrimi i studentëve dy vitet e fundit në programe studimit Master Profesional në “Infermieri Kirurgjikale” (*Standardi II.4, Kriteri 1*)
2. Mos përdorimi i sistemit të automatizuar të korrigjimit CleanScore në FSHMT (*Standardi III.2, Kriteri 1*)
3. Informacioni në faqen zyrtare të Institucionit të jepet edhe në gjuhën angleze. (*Standardi IV.4, Kriteri 6*)

Rekomandime:

1. Rritjen e përpjekjeve nga Institucioni, Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë për rekrutimin e studentëve në këtë program studimi;
2. Literatura e përdorur për këtë program studimi të jetë në formë fizike në Departament ndërsa përditësimi i syllabuseve është i nevojshëm;
3. Numëri i krediteve për praktikën profesionale të rritet;
4. Institucioni të mbështesi pedagogët financiarisht për kërkimin shkencor që ata zhvillojnë duke mbuluar pjesmarrjen e tyre në konferenca ose publikime;
5. Institucioni të hartoj plan masash në bazë të rezultateve të pyetësorit të studentëve dhe të monitoroj implementimin e tij;
6. GVJ rekomandon zhvillimin e vlerësimeve 360° të programit të studimit;
7. Hartimi i një udhëzuesi specifik nga Institucioni për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Nursing Management" provided by the Higher Education Institution University of Elbasan "Aleksandër Xhuvani"

Strengths and affirmations:

1. The study program is offered by academic staff with academic titles and fulfills legal obligations;
2. The capacities of the faculty as well as the laboratory infrastructure are contemporary, with modern equipment in function of the study program;
3. The curriculum of the Professional Master's program in "Surgery Nursing" is designed based on the national legal framework and has high similarities with the same foreign programs;
4. The creation and implementation of an internal management system at UNIEL (EMS program) enables students to have real-time access to the study program, academic achievements, academic staff, etc.
5. Establishment of the Permanent Commission for guaranteeing the quality assurance standards of the Institution and the study programs at Faculty level.

Weaknesses:

1. Non-enrollment of students in the last two years in the study program Professional Master's in "Surgical Nursing" (*Standard II.4, Criterion 1*)
2. The Faculty is not using the automated correction system CleanScore (*Standard III.2, Criterion 1*)
3. The information on the official website of the Institution should also be provided in English (*Standard IV.4, Criterion 6*)

Recommendation:

1. Increasing the efforts of the Institution, the Main Unit and the Basic Unit for the enrollment of students in this study program;
2. The literature used for this study program should be in physical form in the Department, while updating the syllabuses is strongly recommended;
3. Increase the number of credits for professional practice;
4. The institution should support financially the academic staff for the scientific research they conduct by covering conferences fee or publication fee;
5. The institution should draw up a plan of measures based on the results of the students' questionnaire and monitor its implementation;
6. EEC recommends the development of 360° assessment of the study program;
7. The Institution needs to draft a specific guide/manual for the development and use of different and innovative teaching methods/approaches.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X